


MIRË SE VINI

NË KANTONIN VAUD

TË GJITHË INFORMACIONET E NEVOJSHËM MBI PORTALIN E MIRËSEARDHJES



Për t'ju mundësuar të gjeni shpejt referencat tuaja në mjedisin e ri të jetesës tuaj, Portali Mirësevini lehtëson procedurat.

I propozuar nga Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme (BCI), ai vë në dispozicionin tuaj informacionet e nevojshëm për sistemin tuaj, dhe aktualizohet rregullisht.

Portali mundëson të kuptohet më mirë sistemi institucional (lejet e qëndrimit, shkolla, sigurimet, punësimi etj.) procedurat administrative që duhen kryer, si edhe identifikimin e personave që mund t'ju ndihmojnë.

Vizitoni
Portalin



vaud-bienvenue.ch

NJË TRADITË MIKPRITJEJE

Në kantonin e Vaud-it, mirëseardhja e banoreve dhe banorëve të rinj nuk është një shprehje e thjeshtë, por është një traditë dhe një vullnet i plotë politik i autoriteteve të Vaud-it. Kjo kulturë mikëpritjeje mbartet nga shumë faktorë sa shtetërorë e institucionalë, aq edhe bashkëpunues.

Kjo përkthehet në mundësi të ndryshme që synojnë të lehtësojnë sistemimin dhe zbulimin e mjedisit tuaj të ri të jetesës. Ndër to, kjo broshurë e cila do të jetë si një busull që ju drejton, ju informon dhe ju orienton në jetën tuaj të përditshme, familjare por edhe profesionale.

Duke patur parasysh shumëllojshmërinë e popullatës së tij për të cilën dhe krenohet, Kantoni përkthen Broshurën e Mirëseardhjes në shumë gjuhë të ndryshme dhe e vë në dispozicion në mënyrë elektronike për ta bërë atë të aksesueshme për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur.

Ju takon juve që ta zbuloni, ta përdorni dhe ta njihni në format e tij të ndryshme!

Në një kontekst ku është e rëndësishme që lidhja të ruhet dhe të zhvillohet, ne shpresojmë që Broshura e Mirëseardhjes, krijuar si pasojë e një bashkimi të frytshëm të aftësive të vlefshme dhe të ndryshme, do të vazhdojë. ashtu siç ka bërë për shumë vite, të jetë lidhja midis jush dhe kantonit tuaj.

Amina Benkais

Delegate për Integrimin në Kantonin e Vaud-it dhe Shefe e Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme (BCI)

PËRMBLEDHJE

ME MBËRRITJEN TUAJ, ÇFARË DUHET TË BËNI...

4



1 LEJA E QËNDRIMIT

- 1.1 Të punosh, të studiosh, të bashkohesh me një anëtar të familjes.
- 1.2 Hapat për të aplikuar për leje qëndrimi
- 1.3 Azili

6

12

13



2 KURS I GJUHËS FRËNGE

- 2.1 Të mësosh gjuhën frënge
- 2.2 Certifikimet
- 2.3 Mundësitë e kursit të gjuhës

15

16

17

18



3 PUNA

- 3.1 Kushtet për të hyrë në tregun e punës
- 3.2 Përpara se të filloni të punoni
- 3.3 Kam një punë
- 3.4 Nëse humbas punën

28

30

33

36



4 BANESA

39


- 4.1 Të gjesht një banesë 40
- 4.2 Mbështetja 43
- 4.3 Ndarja e mbetjeve 46
- 4.4 Disa rregulla bashkëjetese në komunitet 47



5 SIGURIMET, NDIHMAT SOCIALE DHE TAKSAT

49

- 5.1 Sigurimet shoqërore 50
- 5.2 Sigurimet shëndetësore 51
- 5.3 Sistemi me tri shtylla dhe sigurimi i papunësisë 55
- 5.4 Sigurime në lidhje me lindjen dhe fëmijët 57
- 5.5 Ndihma sociale 58
- 5.6 Sigurime të tjera 61
- 5.7 Taksa 62




27


6 SHËNDETI

63


- 6.1 Ku dhe me kë të konsultohemi 64
- 6.2 Prindërimi dhe lindja 68
- 6.3 Dhuna në familje 71



7 SHKOLLA DHE FORMIMI	73
7.1 Përpara shkollës	74
7.2 Nga 4 në 15 vjeç : shkollë e detyrueshme dhe mikpritja ditore e të rinjve	76
7.3 Nga 15 vjeç	80
7.4 Të gjeni një shkollë pas mbërritjes tuaj	81



8 GJENDJA CIVILE	83
8.1 Të regjistroh një lindje	84
8.2 Njohja e atësisë	85
8.3 Martesa	86
8.4 Procedura në rast vdekje	89



9 JETA E PËRDITSHME	91
9.1 Të udhëtosh në rajonin e Vaud-it	92
9.2 Financat	94
9.3 Telekomunikacioni dhe blerjet	96



10 AKTIVITETET DHE JETA SOCIALE	97
10.1 Fëmijë dhe të rinj	98
10.2 Të rritur	100



11 TË DREJTAT POLITIKE DHE NATYRALIZIMI	105
11.1 Të drejtat politike në nivel komunal	106
11.2 Si funksionon politika në Zvicër?	107
11.3 Të bëhesh zviceran : natyralizimi	108



12 INTERPRETIM DHE PËRKTHIM	111
12.1 Interpretim komunitar	112
12.2 Përkthim me shkrim	113



13 KANTONI I VAUD	115
13.1 Gjeografi	116
13.2 Histori	117



14 KONTAKTE TË NEVOJSHME	121
---------------------------------	------------

ME MBËRRITJEN TUAJ, ÇFARË DUHET TË BËNI...

1

Ju duhet të paraqiteni personalisht në Kontrollin e banorëve të komunës ku ju banoni, **brenda 8 ditëve** të para të zhvendosjes suaj, së bashku me **dokumentet** e mëposhtëm:

- ➔ Një dokument identifikimi të vlefshëm së bashku me vizën e hyrjes nëse nevojitet
- ➔ Kontratën tuaj të qirasë me emrin tuaj të përmendur. Nëse emri juaj nuk shfaqet në kontratën e qirasë, ju duhet të paraqisni:
 - 📄 Një vërtetim me datë dhe firmë nga qiradhënësi juaj (emri juaj duhet të figuroj në këtë dokument)
- ➔ Një foto në format pasaporte

Ju do të paguani një tarifë regjistrimi (maks. 40 fr.) me kartë bankare ose kesh, përveç tarifës së lejes së qëndrimit.

Mund të ndodhë që Kontrolli i banorëve mund t'ju pyes se cilës fe i përkisni. Ky informacion përdoret vetëm për arsye statistike dhe nuk ka asnjë ndikim në procedurat e ardhshme. Përgjigjia është opsionale.



KUJDES

Të gjithë fëmijët në moshë shkollore duhet të shkojnë në shkollë, kjo pavarësisht lejes së tyre të qëndrimit ose periudhës së procedurave administrative.

2

Marrja e një sigurimi shëndetësor të detyrueshem, duhet të kryhet jo më vonë se 3 muaj nga mbërritja juaj.

ME SHUMË INFORMACIONE

📄 5.2 Sigurimi shëndetësor

3

Nëse ju keni fëmijë në moshën shkollore (nisur nga 4 vjeç), ju duhet t'i regjistroni sa më shpejt të jetë e mundur pranë institucioneve shkollore më të afërta.

TË GJESH NJË INSTITUCION SHKOLLOR



📄 7 Shkollimi dhe formimi

🌐 vd.ch > Autorités > Département de la formation, de la jeunesse et de la culture (DFJC) > Direction générale de l'enseignement obligatoire (DGE0) > Les établissements scolaires



1 LEJA E QËNDRIMIT

- | | |
|---|----|
| 1.1 TË PUNOSH, TË STUDIOSSH,
TË BASHKOHESH ME NJË ANËTAR
TË FAMILJES. | 6 |
| 1.2 HAPAT PËR TË APLIKUAR PËR LEJE
QËNDRIMI | 12 |
| 1.3 AZILI | 13 |

1.1 TË PUNOSH, TË STUDIOSH, TË BASHKOHESH ME NJË ANËTAR TË FAMILJES

TË PUNOSH NË ZVICËR

→ Evropian/e e BE-së dhe EFTA

Evropianët/et, shtetasit/et e një shteti të BE-së ose EFTA-s përfitojnë nga lëvizja e lirë e personave me Zvicrën. Ata mund të vijnë dhe të kërkojnë punë për 6 muaj në Zvicër pa vizë dhe mund të vendosen në Zvicër nëse kanë burime të mjaftueshme dhe nuk kanë nevojë për ndihma sociale.

→ Shtetasit/et e vendeve të treta

Është më e vështirë për shtetasit që nuk përfitojnë nga lëvizja e lirë e personave të vijnë dhe të punojnë në Zvicër. Punëdhënësi/ja që dëshiron t'i punësojë ata duhet t'i tregojë Shërbimit të Punësimit (DGEM) se ai ose ajo nuk ka gjetur askënd as në Zvicër (në mesin e banorëve/eve zviceranë ose të huaj) dhe as në Evropë (mes shtetasve/eve të shteteve të BE-së ose EFTA-s) për të marrë këtë pozicion pune. Prandaj, shtetasit e një vendi të tretë që mund të vijnë për të punuar në Zvicër duhet të kenë kualifikime të rrallë dhe të lartë profesionale.

Për më tepër, numri i lejeve që u jepen këtyre shtetasve jashtë BE-së dhe EFTA-s është i kufizuar nga një sistem kuotash. Çdo kantoni i jepet një numër i kufizuar lejesh në dispozicion çdo vit.

TË BASHKOHESH ME NJË ANËTAR TË FAMILJES

Bashkimi familjar lejon bashkëshortin dhe fëmijët e mitur të shoqërojnë ose të bashkohen me një person zviceran ose të huaj që ka leje qëndrimi në Zvicër.

→ Evropianët/et e BE-së dhe EFTA-s

Nocioni i bashkimit familjar është shtrirë edhe tek fëmijët mbi moshën 18, deri në 21 vjeç dhe edhe më të mëdhenj nëse ata apo ato janë ende në ngarkim.

□ LEKSIK

Bashkimi Evropian (BE)

Unioni politiko-ekonomik i njëzet e shtatë shteteve evropiane, të cilët delegojnë ose transmetojnë me traktat ushtrimin e kompetencave të caktuara tek organet e komunitetit.

Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA)

Shoqata e katër shteteve (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra) synojë krijimin e një zone të tregtisë së lirë në Evropë.

Shtet i tretë

Shtet që nuk është anëtar i Bashkimit Evropian ose i Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë. Ky është një shtet me të cilin Zvicra nuk ka marrëveshje për lëvizjen e lirë të personave.

→ Shtetasit/et e vendeve të treta

Një nivel minimal i njohurive të frëngjishtes kërkohet për shtetasit/et madhorë të vendeve të treta që aplikojnë për leje qëndrimi për të shoqëruar ose për t'u bashkuar në Zvicër me një burrë ose grua, ose me një partner/e të regjistruar, gjithashtu shtetas/e të një vendi të tretë.

Në kantonin Vaud-it, nëse nuk fitohet niveli minimal i frëngjishtes, ju keni një vit kohë për të përbushur këtë kërkesë gjuhësore. Për më shumë informacion, shihni në faqen, Nivelet e gjuhës që kërkohen nga Ligji Federal për të Huajt dhe Integrimi (LEI) dhe Ligji Federal për Shtetësinë Zvicerane (LN) në faqet 10-11.

TË STUDIOSSH NË ZVICËR

→ Evropianët/et nga BE-ja dhe EFTA

Për evropianët/et që janë shtetas të BE-së ose EFTA-s, nuk ka kërkesa të veçanta për t'u regjistruar në një institucion-kurs trajnimi në Zvicër. Megjithatë ata, ashtu si dhe shtetasit/et e vendeve të treta, duhet të jenë në gjendje të mbështesin veten financiarisht.

→ Shtetasit/et e vendeve të treta

Shtetasit/et e vendeve të treta duhet të tregojnë se objektivi i tyre për të studiuar në Zvicër është pjesë e një projekti arsimor koherent. Leja e qëndrimit është e përkohshme dhe e vlefshme vetëm për kohëzgjatjen e studimeve.



AFATET PËR BASHKIM FAMILJAR (FËMIJËT)

Shtetasi i një vendi të tretë me leje qëndrimi ka 5 vjet kohë për të sjellë bashkëshortin, bashkëshorten, ose fëmijët e tij nga data e martesës, njohja e përkatësisë ose marrja e lejes së qëndrimit.

Kujdes

Nëse fëmijët kanë mbushur 12 vjeç, afati për bashkim familjar reduktohet automatikisht në vetëm një vit.

Shembull


M. mbërrin në Zvicër në vitin 2020 dhe ka leje qëndrimi. Fëmija i saj 10-vjeçar ndodhet jashtë vendit. Ai ka afat deri në vitin 2023 për të ardhur në Zvicër: fëmija mbush 12 vjeç në vitin 2022 dhe më pas i ka mbetur vetëm një vit për të përfituar nga bashkimi familjar me prindin e tij në Zvicër.

Vërejtje

Këto afate nuk zbatohen për njerëzit që i bashkohen një shtetasi ose një shtetase të BE-së ose EFTA-s.

Kur skadon leja, autoritetet federale dërgojnë një «Njoftim për përfundimin e vlefshmërisë» në komunën tuaj të banimit ose drejtpërdrejt tek ju. Më pas ju duhet të paraqisni një kërkesë për rinovim në komunën tuaj të banimit, e cila do t'ia përcjellë atë shërbimit kompetent kantonale (Shërbimi i popullsisë, SPOP). Gjendja juaj dhe shkalla juaj e integritetit shqyrtohen, veçanërisht autonomia juaj financiare.

Mund të ndodhë që leja e re të mos jepet menjëherë, sepse numri i aplikimeve që trajtohen është i lartë. Në këtë rast, autoritetet kantonale të migracionit sigurojnë që nuk do të vënë në dyshim qëndrimin tuaj derisa aplikimi të jetë shqyrtuar. Nëse dëshironi të udhëtoni jashtë vendit, fillimisht duhet të aplikoni në sportelin e Shërbimit të Popullsisë për një “vizë kthimi” në mënyrë që të mund të ktheheni në Zvicër në mungesë të lejes së re të qëndrimit.



LEJET E NDRYSHME TË QËNDRIMIT

RASTET NË TË CILAT LEJA E QËNDRIMIT APO MOSRINOVIMI I LEJES SË RE TË QËNDRIMIT MUND TË PËRFUNDOJ, TË HIQET OSE TË MOSRINOVOHET

- Vepër penale ose krim që rezulton me një dënim të shoqëruar me vendimin e dëbimit penal.
- Në raste të caktuar, në kushtet e përfundimit të lidhjes bashkëshortore me personin me të cilin është bërë bashkimi familjar.
- Ndihma sociale është marrë në një shumë të konsiderueshme.
- Në përfundim të një kursi (të përfunduar ose të ndërprerë), leja e përkohshme e qëndrimit për studime nuk rinovohet.
- Sapo të njoftohet largimi nga Zvicra ose pas një qëndrimi jashtë Zvicrës prej më shumë se 6 muaj, pa miratimin paraprak të autoriteteve.

B

AUTORIZIM
QËNDRIMI**Shtetas i një vendi të tretë**

Kohëzgjatja prej një viti, mundësisht i rinovuar për 2 vjet.

Evropian/e (BE, EFTA)

Kohëzgjatja më e gjatë se një vit, e rinovueshme për 5 vjet. Mundësia për të punuar varet nga situata e personit.

C

LEJA E
PËRHERSHME

Leja e përhershme e qëndrimit nuk varet më nga arsyeja e pranisë në Zvicër. Leja (dokumenti) rinovohet çdo 5 vjet. Në përgjithësi, leja C u jepet vetëm personave që kanë një leje B, pas 5 ose 10 vitesh në varësi të situatës. Lejon aktivitetet fitimprurës.

F

LEJA E
PËRKOHSHME

U jepet personave që nuk kanë marrë zyrtarisht azil, por që mund të qëndrojnë ligjërisht në Zvicër. Mundësi për të punuar në të njëjtën mënyrë si një mbajtës i lejes B, C ose një zviceran. Në rast të integritetit të mirë (veçanërisht autonomia ekonomike dhe mungesa e shkeljeve) leja F mund të shndërrohet në një leje B.

G

LEJE
KUFIRI

U jepet personave që punojnë në Zvicër, pa patur vendbanimin kryesor aty.

L

LEJE QËNDRIMI
AFATSHKURTËR**Shtetas nga një vend i tretë**

Kohëzgjatja deri në një vit, mund të rinovohet një herë, për një vit.

Evropian/e e (BE, EFTA)

E rinovueshme për kohëzgjatjen e qëndrimit të parë (më pak se një vit). Mundësia për të punuar varet nga situata e personit.

N

LEJE PËR
AZIL-KËRKUES

Sapo personi të largohet nga Qendra Federale për Azilkërkuesit (CFA) dhe të caktohet në një kanton nga Konfederata, ai ka të drejtë të punoj.

S

LEJE PER PERSONA
QE KANE NEVOJE
PER MBROJTJE

Autorizim i përkohshëm qëndrimi në Zvicër. Nuk mund të garantohet e drejta e qëndrimit mbas skadimit të datës se lejes. Sa here që fillohet apo ndërrohet punë duhet të kërkohet një autorizim i përparsëm.



NIVELI GJUHË- SOR QË KËRKOHET ME LIGJ

Ligji Federal për të Huajt dhe Integrimin (LEI) si dhe Ligji Federal për Shtetësinë Zvicerane (LN) kërkojnë që autoriteti kantonal të marrë parasysh aftësitë gjuhësore të personit me shtetësi të huaj. Kështu, Këshilli Federal ka përcaktuar nivelin e gjuhës për bashkim familjar, rinovimin e lejes së qëndrimit (leja B), lëshimin e lejes së përhershme (leja C), si dhe për procedurën zvicerane të natyralizimit.

PRANIMI I PËRKOHSHËM (LEJE F)

A1 ME GOJË

Bashkëshorti/ja nga bashkimi familjar (përfshirë refugjatët e pranuar përkohësisht. Neni. 74.a OASA).

LEJA QËNDRIMIT (LEJE B, JASHTË BE-EFTA)

A1 ME GOJË

Bashkëshorti/ja e mbajtësit të një vendbanimi, ose lejeqëndrimi me bashkim familjar (neni. 73.a OASA). Zgjidhja e martesës ose e familjes (neni. 77 OASA).

E PËRHERSHME (LEJA C NORMALE)

A2 ME GOJË A1 ME SHKRIM

Kusht i zakonshëm pas 10 vitesh qëndrimi (neni. 60 OASA). Kusht i ri pas qëndrimit jashtë vendit (neni. 61 OASA) ose pas integritimit (neni 61a OASA). Bashkëshorti/ja i mbajtësit të lejes së përhershme ose një shtetasi/e zviceran (neni 73b OASA). Shtetasit e disa vendeve* që kanë marrëveshje qëndrimi me Zvicrën janë të përjashtuar nga kërkesa e gjuhës frënge.

NDRYSHIMI I LEJES B NË LEJE C

Leja e përhershme (Leja C) ofron një status më të qëndrueshëm se leja e qëndrimit (Leja B). Pas një periudhe prej 5 deri në 10 vitesh, në varësi të kombësisë dhe arsyes së qëndrimit, është e mundur që një person me leje B të aplikojë për një leje C.

Për shtetasit e vendeve që nuk flasin frëngjisht, është e nevojshme të kenë një certifikatë zyrtare të nivelit francez për të marrë një leje qëndrimi C.

PERSONA PA LEJE QËNDRIMI

Legjislacioni zviceran parashikon në kushte të caktuara mundësinë që një person i cili jeton në Zvicër pa leje qëndrimi të sistemohet nëse integrimi i tij është i suksesshëm dhe nëse kohëzgjatja e qëndrimit të tij është e konsiderueshme dhe e vërtetuar mjaftueshëm. Konkretisht, kërkesa i dërgohet Kantonit (SPOP), i cili vendos nëse do ta përcjellë atë tek autoritetet federale ose jo. Rregullimi bëhet i vlefshëm vetëm pasi është miratuar nga Konfederata.

E PËRHERSHME (LEJE C E PËRSHPEJTUAR)

**B1 ME GOJË
A1 ME
SHKRIM**

Dhënie e parakohshme
pas 5 vitesh qëndrimi
(neni. 62 OASA).

NATYRALIZIMI

**B1 ME GOJË
A2 ME
SHKRIM**

Natyrallizimi i zakonshëm pas 10 vjetësh.
Natyrallizimi më i lehtë
për bashkëshortin/
en e një shtetasi/e
zviceran/e, pas 5
vjetësh (neni. 6 OLN).

1.2 HAPAT PËR TË KËRKUAR NJË LEJE QËNDRIMI

KU TË DREJTOHEMI?

→ Evropianët/et e BE-së dhe EFTA-s

Kontaktoni komunën e vendbanimit në Zvicër (Zyrën e Kontrollit të Banorëve).

→ Persona të tjerë

Kontaktoni përfaqësinë zvicerane (ambasadë ose konsullatë) që ndodhet në vendin tuaj të banimit.

Në të dyja rastet, dosja do t'i dërgohet Departamentit të Popullsisë të kantonit Vaud, i cili do ta përpunojë kërkesën tuaj.

DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR TË BËRË APLIKIMIN

🌐 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes >
Population > Population
étrangère > Entrée et séjour



LEJE QËNDRIMI PËR EVROPIANËT/ET(BE, EFTA): DOKUMENTA TË RINJ NË FORMË KARTE KREDITI

Që prej 1 korrikut 2021, evropianët/et që përfitojnë nga lëvizja e lirë (shtetasit/et e Bashkimit Evropian ose të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë) të cilët marrin ose rinovojnë lejet e tyre të qëndrimit marrin një dokument të plastifikuar në formatin e kartës së kreditit në vend të dokumentit në letër.

Kjo risi nënkupton për ata një rinovim çdo 5 vjet në Qendrën e biometrisë dhe dokumentave të identitetit në Lausanne, (në Flon) për regjistrimin e të dhënave biometrike. Karta e ardhshme do të përfshijë një nënshkrim dhe një foto në formë dixhitale.

Deri më tani, vetëm shtetas të vendeve të treta kishin karta të tilla (që kërkonte një rinovim në Qendrën Biometrike).

KOMPETENCA FEDERALE

Vendimi nëse do të jepet apo jo azil u takon ekskluzivisht autoriteteve federale (Sekretariati Shtetëror për Migracionin dhe Gjykata Administrative Federale). Kantonet nuk kanë asnjë kompetencë për të ndërhyrë në procedurën e azilit.

KRITERET

Kriteret e integritimit nuk përdoren për të vlerësuar kërkesën për azil.

Për të njohur statusin e refugjatit/es dhe për të dhënë azil, autoritetet federale bazohen në faktin nëse personi ka nevojë apo jo për mbrojtje. Ata vlerësojnë nëse është apo jo në rrezik në vendin e tij. Kështu që, kriteret e integritimit në Zvicër nuk përdoren për të vlerësuar kërkesën për azil.

Personat që përfitojnë azil, marrin leje qëndrimi (leje B). Ata që kanë vetëm status refugjati/eje ose që nuk mund të kthehen marrin një “Pranim të përkohshëm” (leje F). Të tjerët duhet të largohen nga Zvicra.

SISTEMIMI I PERSONAVE QË U REFUZOHET AZILI

Në kushte të caktuara, veçanërisht nëse ata kanë qenë në Zvicër për të paktën 5 vjet, pa kryer ndonjë shkelje dhe nëse autoritetet e kanë ditur gjithmonë vendbanimin e tyre, një person, të cilit i është refuzuar azili mund t'i kërkojë Kantonit të paraqesë një propozim për sistemim, me miratimin e autoriteteve federale (neni. 14, pika.2 LAsi).

SHËNIME

[illegible]



2 KURS I GJUHËS FRËNGE

2.1 TË MËSOSH GJUHËN FRËNGE	16
2.2 CERTIFIKIMET	17
2.3 MUNDËSITË E KURSEVE TË GJUHËS FRËNGE	18

2.1 TË MËSOSH GJUHËN FRËNJE

SHKURTIMISHT

Mësimi i gjuhës së vendit në të cilin jeton, lehtëson ndjeshëm jetën e përditshme. Kjo ju lejon të merrni informacion, të gjeni një punë, të komunikoni me fqinjët tuaj, të zhvillonit jetën tuaj shoqërore dhe të ndihmoni fëmijët tuaj në mësimet e tyre.

Ligji i integritetit thekson se është thelbësore që njerëzit të familjarizohen me shoqërinë dhe mënyrën e jetesës në Zvicër, dhe të mësojnë një gjuhë kombëtare. Për disa procedura, si për shembull, rinovimi i lejes, administrata kantonale mund t'ju kërkojë një certifikatë të nivelit të gjuhës frënge.

NIVELI I GJUHËS

🌐 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes >
Population > Population
étrangère > Entrée et
séjour > Loi sur les
étrangers et l'intégration (LEI)



Për fëmijët, shkolla është e detyrueshme nga moshë 4 deri në 15 vjeç në Zvicër. Nxënësve që vijnë nga jashtë, sapo nisin shkollën, u lind e drejta për mësim intensiv të frëngjishtes në shkollë.

MË SHUMË INFORMACIONE

📖 7.2 Nga 4 deri në 15 vjeç: shkolla e detyrueshme dhe kujdesi ditor për fëmijët.

Për të rinjtë e moshës nga 15 deri në 20 vjeç që sapo kanë ardhur, klasat e pritjes i lejojnë të mësojnë frëngjisht dhe të kërkojnë trajnim. Aplikimi për pranim bëhet nëpërmjet Portalit të migracionit.

MË SHUMË INFORMACIONE

📖 7.4 Gjetja e një trajnimi pas mbërritjes

Për të rriturit, shumë kurse të gjuhës frënze ofrohen në të gjithë rajonin Vaud. Në këtë kapitull paraqiten dy lloje kursesh: ato të shkollave private dhe ato të shoqatave.

🔗 KËSHILLË

Një mënyrë shumë e mirë për të mësuar frëngjisht është ta praktikoni atë duke takuar njerëz të tjerë dhe duke marrë pjesë në aktivitete vullnetare, të kohës së lirë ose të integritetit social.

MË SHUMË INFORMACIONE

📖 10 Koha e lirë dhe jeta sociale
📖 7 Shkolla dhe trajnimi

SHKOLLA PRIVATE

Mësimet e frëngjishtes ofrohen nga shkolla private. Këto kurse kanë orare fleksibël dhe kërkesa të ndryshueshme pranimi, me një kosto më të lartë.

Ofertat mund t'i gjeni duke vizituar faqen [local.ch](https://www.local.ch) dhe duke hyrë në motorin e kërkimit "Shkolla e gjuhës".

Faqja e internetit e Shoqatës l'Association vaudoise des écoles privées (AVDEP) përmban një listë të të gjitha këtyre shkollave private.

MË SHUMË INFORMACIONE

🌐 [avdep.ch](https://www.avdep.ch)

TË MARRËSH NJË CERTIFIKATË

Për procedura të caktuara (për shembull: për një kërkesë leje B, rinovim, një leje të përhershme C ose një procedurë natyralizimi), administrata do t'ju kërkojë një certifikatë të nivelit të gjuhës frënge.

Testi i fide-s (frëngjisht, gjermanisht, itali-sht) është një projekt i Konfederatës për inkurajimin gjuhësor të emigrantëve. Ky test ju lejon të kontrolloni aftësitë tuaja me gojë dhe me shkrim dhe të merrni një pasaportë gjuhësore e cila vërteton nivelin tuaj të gjuhës frënge. Organizata të ndryshme ofrojnë këto vlerësime. Për më shumë informacion mbi qëndrat e vlerësimit dhe seancat e provimeve, shihni faqen e internetit, pasaporta e gjuhës.

MË SHUMË INFORMACIONE

 fide-info.ch

Certifikata të tjera njihen gjithashtu për lëshimin e pasaportës së gjuhës, si certifikata, Diplôme d'études en langue française (DELF). Për të marrë këtë certifikatë, duhet të kaloni një provim të gjuhës frënge me shkrim dhe me gojë. Për më shumë informacion mbi seancat e provimeve, vizitoni faqen e internetit të Fondacionit Esprit Frankophonie.

MË SHUMË INFORMACIONE

 delfdalf.ch

 1.1 Punoni, studioni, bashkohuni me një anëtar të familjes

NJËSIMI I DIPLOMËS

Nëse tashmë keni marrë një tjetër certifikatë gjuhe në Zvicër ose jashtë saj dhe është në listën e certifikatave të njohura, mund ta dërgoni në Sekretariatit e Fide. Ata do t'ju lëshojnë, kundrejt një tarife prej 20 frangash, pasaportën gjuhësore që vërteton nivelet përkatëse, me gojë dhe me shkrim.

Nëse keni aftësi gjuhësore në nivelin B1 ose më të lartë, paraqitja e një dosje fide mund të jetë mënyra më e lehtë dhe më e shpejtë për të marrë pasaportën gjuhësore.

MË SHUMË INFORMACIONE

 fide-service.ch/fr/attestations/dossier-fide

2.3 OFERTAT PËR KURSET E GJUHËS FRËNGE

ZONA VERIORE

29	30	31	32	33
34	35	36	37	38
39	40	41		



JURA NORD-VAUDOIS

BROYE-
VULLY

GROS-DE-VAUD

MORGES

LAUSANNE

LAVAUX
ORON

NYON

ZONA E LAUSANNE-S

12	13	14	15	16
17	18	19	20	21
22	23	24	25	26
27	28			

ZONA PERËNDIMORE

42	43	44	45	46
47	48	49	50	51
52	53			

SHOQATA QË OFROJNË KURSE TË GJUHËS FRËNGJE NË KANTON

Shteti subvencionon kurset e frëngjishtes që japin shoqatat. Këto kurse ofrohen nga profesionistë/e të trajnuar dhe janë të aksesueshëm për buxhete të vogla. Kujdesi për fëmijët gjatë orarit të kursit, në disa raste planifikohet paralelisht me kursin. Më poshtë do të gjeni disa nga shoqatat që ofrojnë kurse të gjuhës franceze. Të gjithë detajet në lidhje me të gjitha ofertat janë të disponueshëm dhe të përditësuar në portalin e internetit «Mirësevini në kantonin Vaud».

LISTA E SHOQATAVE ONLINE

 [vaud-bienvenue.ch/
cours-de-francais](http://vaud-bienvenue.ch/cours-de-francais)



ZONA LINDORE

01	02	03	04	05
06	07	08	09	10
11				

PAYS D'ENHAUT

RIVIERA

AIGLE

ZONA LINDORE

01 Appartenances – Espace femmes riviera

Kurse të gjuhës frënge; për gratë emigrante shtatzëna ose nënat e fëmijëve të vegjël, me në qendër temën “Shtatzënia, lindja dhe fëmijëria e hershme”, me pjesëmarrjen e fëmijëve të moshës parashkollore. Pritja, takimi dhe orientimi social për gratë emigrante me ose pa fëmijë.

 Vevey

 021 922 45 23

 ef.vevey@appartenances.ch

 appartenances.ch

02 Association AMIS

Kurse të gjuhës frënge me mikpritje të fëmijëve të moshës parashkollore. Atelie bashkëbisedimi me gratë emigrante dhe zvicerane, si dhe me fëmijët e tyre parashkollore.

 Aigle

 024 466 76 00 | 077 507 62 17

 info@planchette.ch

 planchette.ch

03 Bashkia e Bex/LIBex

Kurse të gjuhës frënge. Kurse për të rritur që kanë një fëmijë që ndjekin shkollën në Bex, të fokusuar në funksionimin e shkollës dhe atelietë e bashkëbisedimit.

📍 Bex

☎ 079 686 61 10

@ francais@bex.ch

04 Bashkia e Château-d'Œx

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Château-d'Œx

☎ 076 387 53 22

@ c.morier-genoud@bluewin.ch

05 Bashkia e Montreux

Kurse të gjuhës frënge. Aktivitete të ndryshme sociale për të mësuar dhe praktikuar frëngjishten.

📍 Clarens

☎ 079 228 62 16

@ info@francais-clarens.ch

🌐 francais-clarens.ch

Bashkëpunime për shkëmbimin dhe informimin e përvojave të jetuara, në frëngjisht, për gratë emigrante të shoqëruara nga fëmijët e tyre.

📍 Clarens

☎ 078 845 86 18

🌐 montreux.ch/habiter-et-decouvrir/integration/associations-et-projets-dintegration

06 Bashkia e Roche

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Roche

☎ 077 407 58 75

@ integration@roche-vaud.ch

07 Bashkia e Villeneuve – Commission d'intégration Villeneuve (CIV)

Kurse të gjuhës frënge dhe atelie bashkëbisedimi.

📍 Villeneuve

☎ 077 407 58 75

@ integration@villeneuve.ch

08 ECAP Vaud

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Vevey

☎ 021 923 59 90

@ infovd@ecap.ch

🌐 ecap.ch/fr

09 Français en jeu

Kurse të gjuhës frënge.

📍 La Tour-de-Peilz, Clarens, Lutry, Paudex, Montreux

☎ 021 552 44 05

@ riviera@francaisenjeu.ch

🌐 francaisenjeu.ch/poles/est-vaudois

Mësimet fillestare të gjuhës frënge për prindërit që duan të mësojnë gjuhën për të kuptuar më mirë se çfarë përjetojnë fëmijët e tyre në shkollën, në Vaud.

📍 Vevey, Clarens, Montreux, Pully, Aigle

☎ 021 552 44 05

@ riviera@francaisenjeu.ch

🌐 francaisenjeu.ch/poles/est-vaudois/

10 Lire et écrire

Kurse leximi dhe shkrimi për të rriturit analfabetë.

📍 Vevey, La Tour-de-Peilz, Clarens, Aigle

☎ 021 922 46 10

@ riviera@lire-et-ecrire.ch

🌐 lire-et-ecrire.ch/vaud

11 Qyteti i Vevey

Kurse të gjuhës frënge. Atelie për shkëmbimin dhe informimin mbi përvojat e jetuara, në gjuhën frënge, për prindërit emigrantë. Atelie bashkëbisedimi për gratë emigrante të shoqëruara nga fëmijët e tyre.

📍 Vevey

📞 021 925 53 18

@ cohesion.sociale@vevey.ch

14 Armée du salut

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 021 312 73 52

🌐 ads-arclemanique.ch

15 Association Nouvelles perspectives

Kurse të gjuhës frënge dhe atelie bashkëbisedimi, të shtunave.

📍 Lausanne, Chavannes-près-Renens

📞 078 848 67 27

@ info@nouvelles-perspectives.ch

🌐 nouvelles-perspectives.ch

ZONA E LAUSANNE-S**🔍 KËSHILLA**

Për një listë të plotë të kurseve të frëngjishtes në Lausanne, ju mund të kontaktoni Zyrën për imigrantët në Lausanne (BLI) (f. 22)

12 Appartenances – Espace femmes Lausanne

Kurse të gjuhës frënge; për gratë emigrante shtatzëna ose nënat e fëmijëve të vegjël, me në qendër temën “Shtatzënia, lindja dhe fëmijëria e hershme”, me mbajtjen e fëmijëve të moshës parash-kollore. Pritja, takimi dhe orientimi social për gratë emigrante me ose pa fëmijë.

📍 Lausanne

📞 021 351 28 80

@ ef.lausanne@appartenances.ch

🌐 appartenances.ch

13 Appartenances – Espace hommes Lausanne

Kurse dhe seminare fillestare në frëngjisht për burra emigrantë. Qendër e pritjes, dëgjimit dhe orientimit për burrat emigrantë në situata të pasigurta psikosociale.

📍 Lausanne

📞 021 320 01 31

@ eh.lausanne@appartenances.ch

🌐 appartenances.ch

16 Association Palabres

Atelie gjuhe frënge dhe hapësire fjale.

📍 Lausanne

@ info@palabres.ch

🌐 palabres.ch

17 Bourse à travail

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 021 323 77 15

@ bourse.travail@gmail.com

🌐 la-bourse-a-travail.ch

18 Communauté Sant'Egidio

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 078 641 08 33

@ francais@santegidio.ch

🌐 santegidio.ch

19 CORREF

Kurse të gjuhës frënge dhe llogaritje.

📍 Lausanne

📞 021 341 71 11

@ administration@corref.ch

🌐 corref.ch

20 ECAP Vaud

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 021 320 13 27

@ infofd@ecap.ch

🌐 ecap.ch/fr

21 EPER

InfoSuisse 50+.

Kurse të gjuhës frënge për të moshuar.

📍 Lausanne

📞 021 613 40 70

@ info@eper.ch

🌐 eper.ch/project-explorer/infosuisse-50

22 Français en jeu

Kurse të gjuhës frënge. Kurse të gjuhës frënge për prindërit që dëshirojnë të mësojnë gjuhën për të kuptuar më mirë ato që fëmijët e tyre përjetojnë në shkollat e Vaud.

📍 Lausanne

📞 021 329 04 49

@ lausanne@francaisenjeu.ch

🌐 francaisenjeu.ch/cours/

23 Lire et écrire

Kurse leximi dhe shkrimi për të rritur analfabetë.

📍 Lausanne

📞 021 329 04 48

@ lausanneetregion@lire-et-ecrire.ch

🌐 lire-et-ecrire.ch/vaud

24 OSTARA

Kurs i gjuhës frënge dhe teknikat mësimore (*Brain Gym*) për gratë emigrante.

📍 Lausanne

@ laure.caron@associationostara.ch

🌐 associationostara.ch

25 Pôle Sud

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 021 311 50 46

@ info@polesud.ch

🌐 polesud.ch/activites-regulieres

26 Université de Lausanne

Kurse të gjuhës frënge (kurse intensive të gjuhës frënge si gjuhë e huaj).

📍 Lausanne

📞 021 692 30 90

@ coursdevacances@unil.ch

🌐 unil.ch/cvac/en/home.html

27 Université populaire de Lausanne

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Lausanne

📞 021 315 24 24

@ info@uplausanne.ch

🌐 uplausanne.ch

28 Bureau lausannois pour les immigrés (BLI) – qyteti i Lausanne

Kurse falas të gjuhës frënge gjatë verës në Vidy-Plage.

📍 Lausanne

📞 021 315 72 45

@ bli@lausanne.ch

🌐 lausanne.ch/vidy-plage

ZONA VERIORE

**29 Appartenances –
Espace femmes Yverdon**

Kurse të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore. Mikpritja, takimi dhe orientimi social për gratë emigrante me ose pa fëmijë.

📍 Yverdon-les-Bains
☎ 024 426 03 36
@ ef.yverdon@appartenances.ch
🌐 appartenances.ch

30 Caritas Vaud

Kurse të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore.

📍 Yverdon-les-Bains
☎ 024 425 32 48

Kurse të gjuhës frënge .

📍 Orbe, Chavornnay
☎ 079 289 10 88
@ coursdefrancais@caritas-vaud.ch
🌐 caritas-vaud.ch/nos-prestations/formations/cours-de-francais

31 CISEROC

Atelie shkëmbimi dhe ndarje eksperiencash të jetuara, në gjuhën frënge.

📍 Orbe
☎ 079 289 10 88
@ ciseroc@orbe.ch
🌐 orbe.ch/ma-ville/integration/ciseroc

32 Bashkia e Yverdon-les-Bains

Kurse të gjuhës frënge të ofruara gjatë verës me çerdhe ditore.

📍 Yverdon-les-Bains
☎ 024 423 69 44
@ integration@yverdon-les-bains.ch
🌐 yverdon-les-bains.ch/vie-quotidienne/cohesion-sociale/integration

33 Bashkia e Payerne

Mësimet të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve të moshës parashkollore dhe atelie bashkëbisedimi.

📍 Payerne
☎ 026 662 68 68
@ helene.lelievre@payerne.ch
🌐 payerne.ch/contrôle-habitants-bureau-etrangers/cours-de-francais

**34 Commission
d'intégration d'Avenches**

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Avenches
☎ 026 675 51 21 | 026 676 72 19
@ integration@commune-avenches.ch
🌐 commune-avenches.ch

35 ECAP Vaud

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Yverdon-les-Bains, Le Sentier
☎ 021 320 13 27
@ infovd@ecap.ch
🌐 ecap.ch/fr

36 Français en jeu

Mësimet fillestare të gjuhës frënge për prindërit që duan të mësojnë gjuhën për të kuptuar më mirë se çfarë përjetojnë fëmijët e tyre në shkollën e Vaud.

📍 Moudon, Lucens
☎ 021 552 44 03
📍 Penthalaz
☎ 021 552 44 06
📍 Échallens
☎ 021 552 44 06
@ gdv@francaisenjeu.ch
🌐 francaisenjeu.ch/cours

37 Le pont du savoir

Atelie për shkëmbimin dhe informimin e përvojave të jetuara, në gjuhën frënge, për gratë emigrante.

📍 Yverdon-les-Bains
☎ 078 661 31 93

38 Lire et écrire

Kurse leximi dhe shkrimi për të rriturit analfabetë. Kujdes i fëmijëve në moshën parashkollore në Yverdon-les Bains.

Yverdon-les-Bains, Orbe..

📍 Yverdon-les-Bains, Orbe,
Le Sentier, Payerne, Lucens,
Moudon

☎ 024 426 15 29

@ nordvaud@lire-et-ecrire.ch

🌐 lire-et-ecrire.ch/vaud

39 Passerelle

Hapësirë mikpritëse për të gjitha gratë emigrante me ose pa fëmijë për të praktikuar frëngjishten.

📍 Le Sentier

☎ 077 434 77 02 | 078 707 97 01

@ passerelle.valleedejoux@gmail.com

🌐 gamvj.wordpress.com

40 Tisserands du monde

Kurse të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore.

📍 Yverdon-les-Bains

☎ 076 239 71 83

🌐 tisserandsdumonde.ch

41 Verso

Kurs i gjuhës frënge.

📍 Yverdon-les-Bains

☎ 024 420 10 45

@ info@verso-yverdon.ch

🌐 verso-yverdon.ch

ZONA PERËNDIMORE**42 Association Bienvenue**

Kurse të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve të moshës parashkollore.

📍 Crissier

☎ 079 453 45 79

@ a-bienvenue@hotmail.com

🌐 association-bienvenue.com

43 Association Franc-parler

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Renens

☎ 021 634 69 63

@ info@franc-parler.ch

🌐 franc-parler.ch

44 Association Nouvelles perspectives

Kurse të gjuhës frënge dhe atelie bashkëbisedimi çdo të shtunë.

📍 Morges, Chavannes-près-Renens

☎ 078 848 67 27

@ info@nouvelles-perspectives.ch

🌐 nouvelles-perspectives.ch

45 CARITAS Vaud

Kurse të gjuhës frënge me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore.

📍 Nyon

☎ 079 621 43 93

📍 Gland

☎ 079 621 43 93

@ info@caritas-vaud.ch

🌐 caritas-vaud.ch/nos-prestations/
formations/cours-de-francais

46 Commune de Cossonay

Kurse të gjuhës frënge me kujdes në çerdhe.

📍 Cossonay

☎ 021 863 22 00

@ secretariat@cossonay.ch

🌐 cossonay.ch/social-et-
sante/cours-de-francais

47 Bashkia e Nyon

Kurse të gjuhës frënge pranë ujit dhe kurse falas të gjuhës frënge gjatë verës.

📍 Nyon

☎ 079 211 02 74

@ integration@nyon.ch

🌐 nyon.ch/integration

48 ECAP Vaud

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Nyon

☎ 021 320 13 27

@ infovd@ecap.ch

🌐 ecap.ch/fr

49 Français en jeu

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Morges

☎ 021 552 44 02

📍 Renens, Prilly

☎ 021 552 44 04

Mësimet fillestare të gjuhës frënge për prindërit që duan të mësojnë gjuhën për të kuptuar më mirë se çfarë përjetojnë fëmijët e tyre në shkollën Vaud. Kurs për përmirësimin e gjuhës së shkruar.

📍 Renens, Écublens

☎ 021 552 44 04

@ ouest@francaisenjeu.ch

🌐 francaisenjeu.ch/cours

50 Globlivres

Atelier për shkëmbimin dhe informimin mbi përvojat në gjuhën frënge me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore.

📍 Renens

☎ 021 635 02 36

@ info@globlivres.ch

🌐 globlivres.ch

51 Lire et écrire

Kurse leximi dhe shkrimi për të rriturit analfabetë.

📍 Prilly, Renens, Écublens

☎ 021 329 04 48

📍 Morges, Nyon, Rolle

☎ 022 366 34 04

@ lacote@lire-et-ecrire.ch

🌐 lire-et-ecrire.ch/vaud

52 Bashkia e Rolle

Kurse të gjuhës frënge.

📍 Rolle

☎ 079 449 70 06

@ edith.norwell@bluewin.ch

🌐 rolle.ch

53 OSTARA

Kurse të gjuhës frënge dhe teknikat e mëimit (Brain Gym) për gratë emigrante me kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore.

📍 Renens

🌐 associationostara.ch

SHĚNIME

[illegible]

Mrs. Paula Barry

Career Objectives

Seeking a position where I will have the opportunity of working in creative, dynamic and fast-moving environment, improving and using all the personal and educated knowledge that not only increase the fiscal viability of the organization, but better my career prospects as well.

Experience

Current Employer
Position Held
Period of Service
Responsibilities

: Vero PR Company, HCMC
: Account Executive & Account Manager
: September 2011- Present

- : Worked as Account Executive for 3 months and now is an Account Manager.
- : Successfully worked with colleagues to organize the company's networking event in Ly's Club on March 1st, 2012 with the participation of more than 250 guests and collected valuable database.
- : Building client relationships to assigned accounts.
- : Providing constant leadership in servicing clients day-to-day and team to handle day-to-day account servicing & dealing with clients.
- : Developing PR strategy planning and over-all project management.
- : Pitching interesting PR stories to send to mainstream & target media.

: Maison Joint Stock Company, HCMC
: PR Marketing Intern
: October 2010- April 2011

Interned for 3 months as PR-Marketing Manager Assistant and worked Marketing Specialist for 4 months.
Worked in the busy PR-Marketing Department, covered all the aspects of PR & Advertising activities. Involved in account, assignment and commendation to colleagues, kept contact and informed with the executives of 10 most famous magazines in Vietnam.
Organized the Creative Strategy Plan to push the sale of all 10 brand branches for the whole 2011.
Designed the Creative Concepts for the fashion show of Charles & Keith collection 2011.
Successfully managed the Fashion Show of Mango & Charles & Keith at the end of 2011.
Worked with PR-Marketing team members to build the Business White Paper 2012 as Director in November 2011, which will be the foundation of Signature.



3 PUNA

3.1 KUSHTET PËR TË HYRË NË TREGUN E PUNËS	28
3.2 PËRPARA SE TË FILLONI TË PUNONI	30
3.3 KAM NJË PUNË	33
3.4 NËSE HUMB PUNËN	36

3.1 KUSHTET PËR TË HYRË NË TREGUN E PUNËS

SHKURTIMISHT

Të kesh një leje qëndrimi nuk të jep domosdoshmërisht të drejtën për të punuar në Zvicër. Kushtet për të hyrë në tregun e punës ndryshojnë sipas lejes së qëndrimit dhe vendit të origjinës.

Çdo person i huaj që merr një leje qëndrimi të lëshuar në kuadër të bashkimit familjar, mund të kryejë një veprimtari fitimprurëse.

→ **Qytetarët/et e BE-së dhe EFTA-s**
Qytetarët/et e Bashkimit Evropian (BE) dhe të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA) mund të punojnë në parim sapo të kenë njoftuar ardhjen e tyre në Kontrollin e Banorëve të komunës së tyre të vendbanimit.

KUSHTET SPECIFIKE PUBLIKE TË AZILIT

Për kushte më specifike të aksesit në tregun e punës, siç janë lejet e caktuara në lidhje me azilin, do të gjeni informacionin e nevojshëm më poshtë.

→ **Licenca F**

Që nga 1 janari 2019, personat me leje qëndrimi F mund të ushtrojnë një veprimtari fitimprurëse të varur ose të pavarur dhe të ndryshojnë punësim dhe profesion, me kusht që kjo veprimtari të jetë deklaruar tek autoritetet. Ligjvënësi në fakt ka konsideruar se ishte e nevojshme të eliminoheshin pengesat administrative për aksesin e tyre në tregun e punës dhe të zëvendësohej procedura e vjetër e autorizimit me një njoftim të thjeshtë të veprimtarisë së tyre.

→ **Leje qëndrimi N, broshurë aplikimi për azil**

Çdo aktivitet profesional i nënshtrohet një kërkesë për autorizim. Marrja në punë është e mundur vetëm pas një vendimi zyrtar pozitiv nga Direction générale de l'emploi et du marché du travail (DGEM).

Sapo dosja për procedurën e azilit të një personi merret nga një kanton (dhe ai largohet nga qendra federale), ushtrimi i një aktiviteti fitimprurës është i mundur në kushte të caktuara. Duhet të respektohen kushtet e zakonshme të shpërblyerimit dhe të punës; rekrutimi i një azilkërkuesi/e nuk

duhet të bie ndesh me prioritetin e dhënë nga legjislacioni për punonjëset dhe punëtorë vendas (zvicëranë ose të huaj/ të huaja që jetojnë në Zvicër) dhe shtetasve/eve të Bashkimit Evropian.

Kantonet gjithashtu kanë të drejtën për të kufizuar veprimtarinë e azilkërkuesve/eve në degë të caktuara ekonomike.

Punësimi mund të lidhet në kuadër të një kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Megjithatë, ai ndërpritet nëse kërkesa për azil refuzohet.

Sapo një vendim negativ për kërkesën e azilit hyn në fuqi (është i ekzekutueshëm), personi nuk ka më mundësinë ligjore për të punuar apo vazhduar një veprimtari fitimprurëse. Nëse ai është i punësuar, ai duhet ta lërë atë në përfundimin e afatit të largimit që ka caktuar Konfederata.

MË SHUMË INFORMACIONE

 1.1 Punoni, studioni, bashkohuni me një anëtar të familjes

Për t'u njohur me kushtet e hyrjes në tregun e punës sipas lejes suaj të qëndrimit, ju mund t'i referoheni Udhëzuesit të Punësimit që gjendet në faqen e mëposhtme të internetit.

KUSHTET E AKSESIT
NË TREGUN E PUNËS
SIPAS LEJES TUAJ
TË QËNDRIMIT

 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes >

Population > Intégration des
étrangers et prévention du
racisme > Publications du BCI



3.2 PËRPARA SE TË FILLONI TË PUNONI

KËRKIM PUNE

Disa rrugë mund t'ju çojnë për të gjetur një punë në Zvicër. Ushtrimi i një aktiviteti punësimi shpesh kërkon procedura paprakte si njohja e shkollimit dhe përvojës suaj profesionale të fituar në vendin tuaj të origjinës.

Nëse jeni duke kërkuar për një punë në kantonin e Vaud, ju mund të:

- ➔ Përgjigjeni ofertave të punës të listuara në internet ose në gazeta.
- ➔ Dërgoni një dosje «aplikimi spontan» tek kompanitë që ju interesojnë. Adresat e kompanive mund t'i gjeni në swissfirms.ch.
- ➔ Regjistroheni në një agjenci punësimi që do të veprojë si ndërmjetës për punë të përkohshme (do t'i gjeni të listuara në faqen e internetit swissstaffing.ch).

MË SHUMË INFORMACION

📖 5.3 Sistemi me tri shtylla dhe sigurimi për papunësinë

💡 KËSHILLË

Mos harroni të telefononi edhe të njohurit tuaj: 75% e njerëzve gjejnë punë në Zvicër përmes rrjetit të tyre social.

DOSJE APLIKIMI

Për t'iu përgjigjur një oferte pune, shumica e punëdhënësve zviceranë do t'ju kërkojnë t'u dërgoni atyre një «dosje aplikimi» që përmban dokumentet e mëposhtme:

- ➔ Një letër motivimi.
- ➔ Curriculum Vitae (CV).
- ➔ Një kopje e diplomave dhe certifikatave të trajnimit.
- ➔ Një kopje e certifikatave tuaja të punës.

Nëse ata janë të interesuar për dosjen tuaj, ata më pas do t'ju kontaktojnë për një ose më shumë intervista të personalizuar.

TË GJENI NJË PROFESION SAPO TË MBËRRINI

Zyra Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle (OCOSP), me Qendrat e saj Rajonale, promovon integrimin profesional dhe punësimin e të gjithë njerëzve, pavarësisht nga mosha dhe formimi i tyre. Ai u ofron aplikantëve/aplikanteve vlerësime, informacione të shumta dhe mbështetje në procesin e ndërtimit të një projekti profesional në Zvicër.

CENTRES REGIONAUX D'ORIENTATION SCOLAIRE ET PROFESSIONNELLE

🌐 vd.ch > Thèmes >
Formation > Orientation >
Contact et adresses de l'OCOSP
et des Centres d'orientation



MËSONI NËSE DIPLOMA JUAJ NJIHET NË ZVICËR

🌐 sbfi.admin.ch > Formation >
Reconnaissance de
diplômes étrangers >
Reconnaissance et autorités
compétentes > Professions
réglementées et notes informatives



KËSHILLIMI PËR NJERËZIT E MBËRRITUR SË FUNDMI

🌐 vd.ch > Thèmes >
Formation > Orienta-
tion > Pour les personnes arrivées
récemment dans le canton de Vaud



Portali i informacionit për këshillim profesional, akademik dhe të karrierës mbledh informacione mbi praktikatat, profesionet dhe trajnimet.

MË SHUMË INFORMACION

🌐 orientation.ch

NJOHJA E DIPLOMAVE TË HUAJA DHE CERTIFIKIMIT PROFESIONAL PËR TË RRRITUR (CPA)

Para se të filloni të punoni në Zvicër, duhet të ndërmerrni hapa për të njohur shkollimin ose përvojën e fituar në vendin tuaj. Në Zvicër, disa profesione janë të “rregulluara”. Ushtrimi i këtyre profesioneve kërkon një titull të njohur zyrtarisht. Për shembull rasti i mjekësisë, infermierisë, arsimit, ku njohja e diplomave është e detyrueshme nëse dëshironi të ushtroni këto profesione. Për profesionet e rregulluara, procedura e njohjes është e detyrueshme.

A keni studiuar jashtë vendit dhe doni të dini nëse diploma juaj njihet në Zvicër? Zbuloni më shumë nga Secrétariat d'État à la formation, à la recherche et à l'innovation (SEFRI).

Të rriturit që kanë vite përvojë profesionale në një profesion të tipit CFC ose AFP kanë mundësi për të marrë titullin e përfundimit të trajnimit duke ndjekur një procedurë kualifikimi për të rriturit në dy mënyra:

- ➔ Ose me dhënien e provimeve të përfundimit të praktikës me mundësi për të ndjekur kurse përgatitore.
- ➔ Ose duke ndjekur një procedurë për vërtetimin e përvojës së fituar (VAE). Kjo përfshin zhvillimin e një dosje portofoli që dokumenton aftësitë që lidhen me ato që kërkohen në profilin e kualifikimit të profesionit të synuar, duke përfutur nga mbështetja kolektive dhe individuale.

Gjithashtu është e mundur, në bazë të kursit tuaj të trajnimit, të mund të ndiqni një trajnim profesional me kohëzgjatje të reduktuar.

ÇERTIFIKIME PROFESIONALE PËR TË RRRITUR (CFC, AFP) Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle (OCOSP)

☎ 021 557 88 99

@ info.cpa@vd.ch

🌐 vd.ch/certification-adulte

INTEGRIMI PROFESIONAL

Shumë shoqata kanë zhvilluar projekte të integrimit profesional për emigrantët. Këto projekte mund t'ju ndihmojnë në kërkimet tuaja për punësim ose trajnim. Disa prej tyre janë të listuara në portalin Mirësevini në kantonin Vaud.

SHOQATA PËR INTEGRIM PROFESIONAL

 vaud-bienvenue.ch > Travail



VULLNETARIZMI

Përveç zgjerimit të fushës së aftësive dhe rrjetit tuaj, vullnetarizmi mund të jetë një trampolinë për të fituar një punë me pagesë. Nëse dëshironi të angazhoheni disa orë në javë për një kauzë që është e dashur për ju ose të krijoni një shoqatë, mund të konsultoheni me Vullnetariati-Vaud.

MË SHUMË INFORMACIONE

Bénévolat-Vaud, Centre de compétences pour la vie associative

 Avenue Ruchonnet 1
1003 Lausanne

 021 313 24 00

 info@benevolat-vaud.ch

 benevolat-vaud.ch

 10 Koha e lirë dhe jeta sociale

MASAT E INTEGRIMIT PROFESIONAL TË ASISTENCËS PËR PAPUNËSINË

Masat e integrimit profesional janë të aksesueshme, në kushte të caktuara, për njerëzit e regjistruar në Zyrën Rajonale të Punësimit (ORP) në rajonin e tyre dhe të cilëve u është dhënë e drejta për përfitimet e asistencës për papunësinë.

KRIJIMI DHE ZHVILLIMI I BIZNESIT

Kantoni i Vaud-it ofron një kornizë të favorshme për krijimin dhe zhvillimin e bizneseve. Service de la promotion de l'économie et de l'innovation (SPEI) udhëzon sipërmarrësit në përpjekjet e tyre dhe i drejton tek organizatat përkatëse sipas nevojave të tyre (këshilla, financime, mbështetje teknologjike, etj.). Mbështetjet janë të disponueshme për kompanitë aktive në sektorët industrialë dhe të teknologjisë së lartë.

SERVICE DE LA PROMOTION DE L'ÉCONOMIE ET DE L'INNOVATION (SPEI)

 Rue Caroline 11

1014 Lausanne

 021 316 60 21

 info.spei@vd.ch

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vaud (CVCI) ofron një shërbim këshillimi për hapjen e biznesit.

CHAMBRE VAUDOISE DU COMMERCE ET DE L'INDUSTRIE (CVCI)

 021 613 35 35

 creation@cvci.ch

 cvci.ch Services > Entreprendre en pratique > Création d'entreprise

TË GJENI NJË ZGJIDHJE KUJDESI PËR FËMIJËN TUAJ

Gjatë kërkimeve për punë, është thelbësore që prindi të planifikojë paraprakisht një zgjidhje për kujdesin e fëmijëve.

MË SHUMË INFORMACIONE

 7.1 Para shkollës

SHKURTIMISHT

Veprimtaria profesionale u nënshtrohet të drejtave dhe detyrave. Kushtet e punësimit, detyrimet tatimore dhe kontratat kolektive të punës mund të duken komplekse fillimisht. Ato janë në fakt më të lehta për t'u kuptuar se sa duket dhe thelbësore të njihen. Këtu do të gjeni detajet që kërkon.

KONTRATA E PUNËS

Kur një punëdhënës vendos t'ju punësojë, ai ose ajo do t'ju kërkojë të nënshkruani një kontratë pune. Edhe pse kontrata e punës mund të lidhet gojariisht, në Zvicër praktika e lidhjes së kontratës është me shkrim. Në të gjitha rastet, duhet të diskutohen kushtet e angazhimit përpara se të filloni aktivitetin tuaj profesional (kohëzgjatja e kontratës, koha e punës, shuma e pagës vjetore, lloji i punës që do të kryhet, zbritjet sociale, orët, pushimet, periudha e provës dhe periudha e njoftimit, etj.).

PAGA

Në Zvicër, niveli i pagave ndryshon shumë në varësi të sektorit të aktivitetit dhe rajonit. Ato negocohen individualisht ose kolektivisht. Ligji zviceran nuk përcakton një pagë minimale: shuma e pagës caktohet më shpesh në marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit ose punonjëses në kohën e angazhimit.

Megjithatë, disa marrëveshje kolektive të punës (KKT) dhe kontrata standarde të punës (KPT) parashikojnë për kategori të caktuara profesionesh, paga minimale të detyrueshme. Paga dakordësohet ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit ose punonjëses. Varet nga shumë faktorë (përvoja, kualifikimet, rajoni, etj.). Shuma e pagës është fikse çdo muaj ose për orë pune. Pagat përgjithësisht paguhet në fund të muajit nga punëdhënësi ose punëdhënësjë nga llogarinë tuaj bankare ose postare. Është e rëndësishme të kontrolloni nëse paga juaj është paguar në llogarinë tuaj. Punonjësit/et në përgjithësi marrin një deklaratë mujore pagash.

Punonjësit/et mund të kryejnë një njoftim zyrtar ndaj punëdhënësit ose punëdhënëses për t'u paguar, brenda një periudhe të përshtatshme, me pagën e tyre dhe të kërcënojnë se do të ndërpresin veprimtarinë e tyre profesionale nëse nuk e kanë marrë shpërblimin në kohën e duhur, me kusht që të kenë kryer më parë punën e kontraktuar. Një pagë e 13-të duhet të paguhet vetëm nëse është rënë dakord shprehimisht në kontratën e punës ose nëse parashikohet nga një CCT ose CTT në fuqi.

Për punën e kryer përkohësisht natën, të dielën dhe ditët e festave publike, përgjithësisht jepet një shpërblim i veçantë. Por ky nuk është rasti kur puna e natës ose e dielës është e rregullt.

Për të mësuar rreth pagave në një profesion, ekzistojnë përlogaritës pagash, disa prej të cilëve janë renditur në linkun e mëposhtëm.

PËRLLLOGARITËSIT E PAGËS

 orientation.ch > Travail et emploi > salaire

Punëdhënësi ose punëdhënësjë duhet të respektojë parimin e barazisë midis grave dhe burrave në fushën e pagave. Bureau de l'égalité entre les femmes et les hommes do t'ju tregojë se si të veproni në rast të diskriminimit në marrëdhëniet e punës.

BUREAU DE L'ÉGALITÉ ENTRE LES FEMMES ET LES HOMMES

 Rue Caroline 11
1014 Lausanne
 021 316 61 24
 info.befh@vd.ch

ZBRITJET SOCIALE

Pagat e caktuara në një kontratë pune tregohen në shumën bruto. Zbritjet sociale ndahen në mënyrë të barabartë midis kompanisë dhe punonjësit/es. Këto përfshijnë sigurimin e pleqërisë dhe të mbijetuarve (AVS), sigurimin e invaliditetit (AI), kompensimin për humbjen e të ardhurave (APG), sigurimin e asistencës së papunësisë (AC), përfitimet suplementare kantonale për familjet (PCFam) dhe sigurimin e aksidenteve joprofessionale (AANP). Tarifa është plotësisht në ngarkim të kompanisë.

MË SHUMË INFORMACION

 5.3 Sistemi me tre shtylla dhe sigurimi për papunësinë

KOHËZGJATJA E PUNËS

Puna me pagesë lidhet me një kohë fikse pune për të cilën punonjësi/ja paguhet. Ligji zviceran përcakton një kohë maksimale të punës në:

- ➔ 45 orë në javë për punonjësit/et në ndërmarrjet industriale, stafin e zyrave, stafin teknik dhe stafin e shitjeve në zinxhirët e mëdhenj të shitjes me pakicë.
- ➔ 50 orë në javë për punëtorët/punëtoret e tjerë.

FAMILJA

➔ Shtatzënia

Disa ligje në Zvicër rregullojnë të drejtat e punëtoreshave shtatzëna, punëtoreshave që kanë lindur, si dhe nënave gjidhënëse. Këto janë p.sh.: kushtet e punës dhe kohëzgjatja normale e ditës së punës për gratë shtatzëna, mbrojtja kundër pushimit nga puna gjatë shtatzënisë dhe deri në gjashtëmbëdhjetë javë pas lindjes, ndalimi i punës për tetë javët e ardhshme të lindjes, pushimi i lehonisë, e drejta për kohën e dhënies së gjirit gjatë punës etj.

➔ Atësia

Burrat që bëhen baballarë kanë të drejtën e lejes së atësisë dhjetë ditë pune që prej 1 janarit 2021.

MATERIATI – MBROJTJA E PUNËTORËVE, SECO

 seco.admin.ch >
Services et publications >
Publications >
Travail > Conditions de travail >
Brochures et dépliants



RREGULLIMI I KOHËS SË PUNËS DHE TË MATËSISË

🌐 seco.admin.ch > Services et publications > Publications > Travail > Conditions de travail > Aide-mémoires et listes de contrôle.



SHTESAT FAMILJARE

Shtesat familjare synojnë të kompensojnë një pjesë të shpenzimeve që prindërit duhet të paguajnë për mirëqënien e fëmijëve të tyre.

MË SHUMË INFORMACION

📖 5.4 Sigurimet në lidhje me lindjen dhe fëmijët

KAM NJË PROBLEM ME PUNËDHËNËSIN/EN TIME ÇFARË DUHET TË BËJ?

Shumë shoqata të punëtorëve dhe punëtorëve, të quajtura «sindikata», janë në dispozicion për t'ju ofruar informacion mbi punën dhe/ose për t'ju mbështetur në çdo konflikt me punëdhënësin/en tuaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

🌐 usv-vaud.ch

Midis tyre, sindikata UNIA është e specializuar për të drejtat e njerëzve me prejardhje emigrimi. Kjo sindikatë ka disa zyra të shpërndara në territorin e Vaud-it.

MË SHUMË INFORMACIONE UNIA

📍 Place de la Riponne 4
1005 Lausanne
📞 0848 606 606
✉ vaud@unia.ch
🌐 vaud.unia.ch

PUNA E PADEKLARUAR

Në Zvicër, puna e padeklaruar, e quajtur edhe «puna në të zezë» është e paligjshme. Flitet për punë të padeklaruar kur nuk respektohet një nga detyrimet e shpalljes apo autorizimit lidhur me ligjin e sigurimeve shoqërore, ligjin e të huajve apo ligjin tatimor.

Në momentin që një person punon në tregun e zi, nuk ka të garantuar rrogën apo sigurinë në punë. Megjithatë varet kryesisht nga vullneti i mirë i kompanisë, ai megjithatë ka të drejta për të kërkuar. Kontrata me gojë e punës garanton kushte minimale pune, si të drejtën për pagë në përputhje me zakonet dhe profesionin vendas, të drejtën për pushime me pagesë, vazhdimin e pagesës për një kohë të caktuar në rast aksidenti ose sëmundjeje, respektimin e afateve në rastin e zgjidhjes së kontratës. Në rastin e punës së padeklaruar, punonjësi/ja mund të kërkojë dialog me punëdhënësin ose punëdhënësen e tij/saj. Në rast dështimi, ai ose ajo mund të ankohet në një sindikatë (përfshirë punonjësit/et pa leje qëndrimi) ose në Gjykatën e Punës. Në rast të punës së padeklaruar, kompania sanksionohet nga autoritetet.

TAKSA

Kushdo që jeton ose ka një burim të ardhurash në kantonin e Vaud-it, duhet të paguajë taksë, në raport me pagën dhe pasurinë e tij.

MË SHUMË INFORMACIONE


📖 5.7 Taksat

3.4 NËSE HUMBAS PUNËN

Humbja e vendit të punës është një situatë me të cilën ju mund të përballeni. Institucionet, të tilla si Zyrat rajonale të vendosjes (ORP), do t'ju ndihmojnë, veçanërisht për të lehtësuar integrimin tuaj në botën e punës. Nëse planifikoni të vetëpunësoheni, Shërbimi i promovimit të ekonomisë dhe inovacionit (SPEI) mund t'ju mbështesë.

MË SHUMË INFORMACIONE

 3.2 Para se të punoj



ASISTENCA E PAPUNËSISË

Në rast të humbjes së vendit të punës, është e nevojshme të raportoni sa më shpejt që të jetë e mundur (në mënyrë ideale të paktën një muaj përpara nëse e dini datën në të cilën përfundon kontrata juaj) në Office régional de placement (ORP) të rajonit tuaj. Kjo do t'ju lejojë të merrni mbështetjen nga një profesionist/e për të lehtësuar riintegrimin tuaj në tregun e punës dhe për t'u regjistruar në mënyrë që të merrni ndihmë financiare nga asistenca për papunësinë.

Bashkangjitur me Koordinimin e ORP-ve të shërbimit të punësimit, offices régionaux de placement (ORP) janë të shpërndara në të gjithë kantonin e Vaud.

INFORMACIONE MBI ZYRAT RAJONALE TË VENDOSJES

 vd.ch > Thèmes > Économie >
Demandeurs d'emploi

MË SHUMË INFORMACIONE

 3.2 Përpara se të nisni punë

01 ORP Aigle

 Rue de la Zima 4
Case postale 187 | 1860 Aigle
 024 557 77 40
 orp.aigle@vd.ch

02 ORP Échallens

 Place du Château 10 B
Case postale 231 | 1040 Échallens
 021 557 18 90
 orp.echallens@vd.ch

03 ORP Lausanne

 Place Chauderon 9, kati 3
Case postale 5032 | 1002 Lausanne
 021 315 78 99
 orp@lausanne.ch

04 ORP Morges

 Avenue de la Gottaz 30
Case postale 2056 | 1110 Morges
 021 557 92 00
 orp.morges@vd.ch

05 ORP Gland

 Avenue du Mont-Blanc 24
1196 Gland
 022 557 53 60
 orp.gland@vd.ch

06 ORP Ouest Lausannois, Prilly

 Route de Renens 24
1008 Prilly
 021 557 04 50
 orp.orpol@vd.ch

07 ORP Payerne

 Rue de Guillermaux 1
1530 Payerne
 026 557 31 30
 orp.payerne@vd.ch

08 ORP Pully

 Avenue Charles-Ferdinand-Ramuz 43
Case postale 240 | 1009 Pully
 021 557 19 10
 orp.pully@vd.ch

09 ORP Riviera, Vevey

 Quai de Copet 1
1800 Vevey
 021 557 15 00
 orp.riviera@vd.ch

10 ORP Yverdon-les-Bains

 Rue des Pêcheurs 8A
1400 Yverdon-les-Bains
 024 557 69 00
 orp.yverdon@vd.ch

11 ORP Orbe

 Rue des Remparts 23
Case postale 165 | 1350 Orbe
 024 557 79 70
 orp.orbe@vd.ch

SHËNIME

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and extend across the width of the page. There are no margins or other markings on the paper.



4 BANESA

4.1 TË GJESH NJË BANESË	40
4.2 MBËSHTETJE	43
4.3 NDARJA E MBETJEVE	46
4.4 DISA RREGULLA BASHKËJETESE NË KOMUNITET	47



4.1 TË GJESH NJË BANESË

TË BANOSH NË KANTONIN VAUD

Në kantonin Vaud, gjetja e një banese mund të marrë kohë dhe të jetë e vështirë për shkak të situatës së tensionuar të tregut të pasurive të paluajtshme. Duhet të theksohet gjithashtu se qeratë janë shpesh më të shtrenjta në qytete sesa në zonat periferike, prandaj është gjithashtu e mundur të kërkon banesa që gjenden më shumë në periferi. Periferitë janë zona që përgjithësisht shërbejnë shumë mirë nga transporti publik.

Më e zakonshme është të marrësh me qera një apartament ose një shtëpi nëpërmjet një agjencie imobiliare (të quajtur edhe agjensi ndërmjetëse). Ju do të gjeni reklama për banesa të disponueshme në internet ose në faqet e internetit të kompanive imobiliare.

Nëse jeni të interesuar për një banesë, keni mundësinë ta vizitoni atë. Nëse ju përshtatet, atëherë mund të paraqisni dosjen tuaj të aplikimit te agjensitë. Në reklamën online do të gjeni kontaktin e qiramarrësit ose agjensisë që do t'ju tregojë apartamentin. Megjithatë, duhet të theksohet, se vizita e një banese nuk garanton marrjen e saj.

🔔 KËSHILLË

Bisedoni me ata që ju rrethojnë dhe përdorni rrjetet sociale.



KUDJES

Mashtrimet me qiratë e apartamenteve janë të zakonshme. Kujdes nga një ofertë që duket shumë tërheqëse ose nga kushtet për paraqitjen e një dosjeje, që ju duken jonormale. Për më shumë informacion mbi mashtrimet me qira të apartamenteve, vizitoni faqen e internetit të policisë kantonale të Vaud:

🌐 votrepolice.ch > Criminalité > Arnaque à la location d'appartements

DORËZIMI I DOSJES NË NJË AGJENSI IMOBILIARE

Nëse pas vizitës, ju pëlqeu banesa, mund të shkoni tek agjensia dhe të dorëzoni dosjen tuaj që përmban elementët e mëposhtëm:

- ➔ Formulari i informacionit të agjensisë.
- ➔ Kopje e kartës së identitetit dhe/ose leje qëndrimi.
- ➔ Kopje e rrogave për 3 muajt e fundit.
- ➔ Ekstrakt të fundit nga zyrat e ndjekjes penale.

OFFICE DES POURSUITES

 vd.ch > [Autorités](#) > [Ordre judiciaire](#)
[vaudois](#) > [Offices des poursuites](#)

- ➔ Certifikatë sigurimi familjar dhe përgjegjësie civile (jo e detyrueshme por e kërkuar).

MË SHUMË INFORMACIONE

 5.6 Sigurime të tjera

- ➔ Nëse nuk i plotësoni të gjitha këto kushte, ju mund t'i kërkonit dikujt që njihni që të bëhet garant për ju.

Nëse keni ndonjë pyetje, mund të kontaktoni drejtpërdrejt me agjensinë.

KONTRATA E QIRASË DHE GARANCIA E QIRASË

Pas marrjes së banesës, një kontratë qiraje nënshkruhet midis qiramarrësit dhe agjensisë. Shpesh është zakon të paguhet një garanci për qiranë, e cila është e barabartë me qiranë e dy ose tre muajve, brenda 30 ditëve.

Ju keni dy alternativa në varësi të mundësive tuaja financiare:

- ➔ Të shkoni në një bankë me kontratën e qirasë, një dokument identiteti dhe të hapni një llogari bankare «garanci qiraje» në emrin tuaj. Aty mund të depozitoni shumën e kërkuar, e cila do të bllokohet deri në dorëzimin e banesës.
- ➔ Të telefononi një të njohur ose një kompani sigurimi që do të veprojë si garant për ju. Shuma e garancisë suaj të qirasë do të paguhet nga kompania e garancisë që ju keni zgjedhur. Në këmbim, do t'ju duhet të paguani një shumë vjetore, d.m.th. rreth 5% të një shume, ekuivalente me trefishin e qirasë mujore.

INVENTARI, QIRAJA DHE DETYRIMET

Kur hyni në apartament, gjatë inventarizimit, sigurohuni që të shënohen të gjithë dëmet e bëra nga ish-qiramarrësi dhe të kërkonit punime shtesë nëse është e nevojshme. Qiraja e banesës paguhet në fund të muajit, për muajin pasardhës. Në faturën e qirasë do të gjeni edhe shpenzime shtesë që përfaqësojnë pagesat e qirasë (ngrohje, mirëmbajtje) si dhe shpenzime të tjera nga shërbimet industriale si (energji elektrike, uji). Disa qira përfshijnë tarifa shërbimi. Në këtë rast ju paguani një tarifë paradhënie. Pronari/pronarja duhet të hartojë një llogari të detajuar, të paktën një herë në vit dhe, në varësi të shpenzimeve tuaja, do të rimbursoheni ose do t'ju kërkojë një shtesë në fund të vitit. Si të gjitha faturat, pasqyra e shpenzimeve duhet të kontrollohet me kujdes.

FORMALITETET DOGANORE

Që të mund të sillni gjërat tuaja nga jashtë (mobilje, vetura etj.), duhet që të transferoni vendbanimin në Zvicër. Më pas, gjatë zhvendosjes, do të paraqisni në zyrën doganore:

- ➔ Një kontratë qiraje ose një kontratë pune si vërtetim.
- ➔ Formulari doganor 18.44 “Përpunimi doganor i sendeve shtëpiake”. Shpenzimet që lidhen me këto procedura mund të zbriten nga taksat tuaja.

ADMINISTRATION FÉDÉRALE DES DOUANES

 ezv.admin.ch

REGJISTRIMI PËR KONTROLLIN E BANORËVE TE KOMUNËS TUAJ

Brenda 8 ditëve nga shpërngulja, duhet të regjistroheni në Kontrollin e banorëve të komunës tuaj.

ASSOCIATION VAUDOISE DES CONTRÔLES DES HABITANTS ET BUREAUX DES ÉTRANGERS

 avdch.ch > Communes

Stafi në sportel do t'ju mirëpresë dhe me kënaqësi do t'ju përgjigjet pyetjeve tuaja në lidhje me regjistrimin tuaj në komunë (leje qëndrimi, shkollë, kujdesi për fëmijët, qendra e grumbullimit të mbeturinave, etj.). Mos hezitoni t'i kontaktoni me pyetjet tuaja.

ZGJIDHJA E KONTRATËS TUAJ TË BANIMIT

Kontrata e qirasë mund të ndërpritet nga qiramarrësi/ja dhe nga qiradhënësi/ja Kushtet dhe afatet që duhen respektuar përcaktohen në kontratë. Qiramarrësit që dëshirojnë të largohen nga banesa e tyre duhet të përfundojnë qiranë e tyre brenda afateve të dakortësuara me shkrim dhe me letër rekomande.

Nëse jeni i martuar ose bashkëjetoni të regjistruar, zgjidhja e kontratës është e vlefshme vetëm nëse të dy personat që jetojnë në banesë e kanë nënshkruar atë. Në përgjithësi, njoftimi për banesën është 3 muaj. Ndërprerja e kontratës duhet t'i arrijë qiradhënësit para datës së caktuar (jo më vonë se një ditë para fillimit të periudhës së përfundimit). Periudha e njoftimit zakonisht shkruhet në kontratën e qirasë; nëse nuk është kështu, duhet të respektohen afatet ligjore në fuqi në kanton.

Nëse keni ndërmend të lini banesën tuaj jashtë afateve kohore të parashikuara në kontratë pa pasur nevojë të paguani qiranë tuaj deri në përfundimin e qirasë, ju duhet të propozoni një qiramarrës tjetër që qiradhënësi/ja mund ta pranojë në mënyrë të arsyeshme: ky ose kjo qiramarrës duhet të ketë aftësi paguese dhe të jetë i gatshëm për të marrë qiranë tuaj me të njëjtat kushte. Qiradhënësi/ja ka 30 ditë për të kontrolluar nëse qiramarrësi i propozuar i plotëson kushtet e marrëveshjes së qirasë dhe nëse mund të paguajë qiranë.

NDIHMË PËR STREHIM

Nëse për arsye financiare ose sociale, keni vështirësi në gjetjen dhe/ose mbajtjen e një banese të qëndrueshme, ju mund t'i drejtoheni fondacionit Le Relais dhe strukturave të Rel'og për të përfituar nga ndihma e tyre. Të gjitha shërbimet e tyre janë plotësisht falas dhe të hapura për këdo që ka nevojë.

Fondation Le Relais

Permanences Morges

📍 Grand-Rue 82

1110 Morges

☎ 021 804 88 11

@ info@relais.ch

🌐 relais.ch > Prestations > Se loger

Rel'og

Perëndim Lausanne

📍 Avenue de la Poste 3

1020 Renens

☎ 021 923 35 38

@ relog.renens@relais.ch

Vevey

📍 Rue de Lausanne 17

1800 Vevey

☎ 021 923 09 20

@ relog.vevey@relais.ch

Yverdon-les-Bains

📍 Avenue Haldimand 8

1400 Yverdon-les-Bains

☎ 021 923 35 30

@ relog.yverdon@relais.ch

SHOQATA E MBROJTJES SË QIRAMARRËSVE (ASLOCA)

Në rast të një problemi me qiradhënësin ose agjensinë tuaj, Association suisse des locataires (ASLOCA) ofron ndihmë juridike dhe këshilla për një pagesë prej 70 frangash në vit. Ju mund të përfitoni duke u anëtarësuar në këtë shoqatë. Anëtarësimi do t'ju japë të drejtën të merrni informacione mbi ligjin e qiramarrjes me anë të telefonit, konsultime ligjore me anë të takimeve, si dhe mbështetje në procedurat tuaja që lidhen me banesat.

Kini parasysh se disa shërbime nuk përfshihen në tarifën vjetore dhe mund të kenë kosto shtesë.

🔔 INFORMACION I NEVOJSHËM

Qiramarrësi/ja ka të drejta. Për shembull, ai ose ajo mund të kundërshtojë shumën e qirasë së tij. Association suisse des locataires (ASLOCA) është aty për të këshilluar qiramarrësit në këtë proces.

MË SHUMË INFORMACIONE ASLOCA

🌐 asloca.ch > Se défendre > Contestation du loyer initial

ASLOCA Vaud

Broye Vaudoise

- 📍 Avenue de la Gare 9
- Case postale 16 | 1522 Lucens
- 📞 021 906 60 45

La Côte

- 📍 Chemin des Plantaz 13a
- 1260 Nyon
- 📞 022 361 32 42

Lausanne

- 📍 Rue Jean-Jacques-Cart 8
- Case postale 56 | 1006 Lausanne
- 📞 084 017 10 07

Montreux – Lindor Vaud

- 📍 Avenue des Alpes 5
- Case postale 1024 | 1820 Montreux
- 📞 021 963 34 87

Morges

- 📍 Rue de la Gare 3
- Case postale 24 | 1110 Morges 1
- 📞 084 017 10 07

Veru Vaud

- 📍 Avenue des Sports 28
- Case postale 92 | 1401 Yverdon-les-Bains
- 📞 084 017 10 07

Renens

- 📍 Rue de Lausanne 31b
- 1020 Renens
- 📞 084 017 10 07

Vevey-La-Tour-de-Peilz

- 📍 Rue du Simplon 40
- Case postale 38 | 1800 Vevey
- 📞 021 922 79 62

STREHIMI ME URGJENCË

Nëse e gjeni veten në një situatë të vështirë, banesat urgjente ekzistojnë dhe ofrohen nga shërbime dhe shoqata të ndryshme.

MË SHUMË INFORMACIONE

Le Portail Caritas

Ai ofron strehim urgjent dhe apartamente për periudha të shkurtra

🌐 caritas-vaud.ch > Nos prestations > Hébergement

Le Hublot

Qendra e strehimit urgjent e Riviera-s

- 📍 Rue du Clos 8
- 1800 Vevey
- 📞 021 921 49 00
- @ lehublot@caritas-vaud.ch

La Lucarne

Qendra e strehimit urgjent në Veri të Vaud-it

- 📍 Curtil-Maillet 23
- 1400 Yverdon-les-Bains
- 📞 024 420 33 84
- @ lalucarne@caritas-vaud.ch

Association Sleep-In

Qendra e strehimit urgjent në Lausanne

- 📍 Chemin de l'Usine-à-Gaz 10
- 1020 Renens
- 📞 021 625 66 77
- @ admin@sleep-in.ch

Étape Saint-Martin

Qendra e strehimit urgjent në Lausanne

- 📍 Rue Saint-Martin 16
- 1003 Lausanne
- 📞 021 315 72 69

La Marmotte

Qendra e strehimit urgjent në Lausanne

- 📍 Rue du Vallon 17
- 1005 Lausanne
- 📞 021 311 79 12
- @ marmotte@armedusalut.ch

Poste de l'Arc Lémanique

📍 Rue de la Louve 10
1003 Lausanne
📞 021 312 73 52

BANESA TË SUBVENCIONUARA

Disa komuna në kantonin Vaud ofrojnë banesa të subvencionuara të destinuara për qiramarrës me mundësi të pakta financiare. Në të vërtetë, për të qenë në gjendje të përfitosh nga banesat e subvencionuara, qiramarrësit duhet të plotësojnë kushtet e të ardhurave, pasurisë dhe shkallës së banimit (numri i banorëve/eve në raport me numrin e dhomave në banesë). Të gjitha këto kritere do të vlerësohen, pasi të aplikoni për strehim të subvencionuar, për të përcaktuar nëse jeni në gjendje të përfitoni ose jo nga ky lloj subvencionimi.

Lista e banesave të subvencionuara në kantonin Vaud përditësohet rregullisht. Nëse keni nevojë për këshilla dhe informacion mbi këtë temë, kontaktoni Direction du logement (DIL).

DIRECTION GÉNÉRALE DU
TERRITOIRE ET DU
LOGEMENT (DGTL) –
DIRECTION DU
LOGEMENT (DIL)

📍 Rue Caroline 11 bis
1014 Lausanne

📞 021 316 64 00

✉ info.logement@vd.ch

🌐 [vd.ch > Thèmes > Territoire et construction > Logement > Aides en matière de logement dans le canton de Vaud > Aide à la pierre](#)



NDIHMA INDIVIDUALE PËR STREHIM (AIL)

Ndihma për strehimin individual (AIL) jepet në disa komuna të kantonit. Ajo ofron mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për familjet që:

- ➔ Kanë mjete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e tyre.
- ➔ Paguajnë një tarifë qiraje që është shumë e lartë në raport me të ardhurat e tyre.
- ➔ Nuk përfitojnë të ardhura nga integrimi (ndihma sociale e Vaud) dhe as përfitime të tjera AVS/AI.

AIL përllogaritet sipas situatës familjare, të ardhurave dhe qirasë që familja paguan. Kriteret për dhënien e AIL janë përcaktuar në nivel kantonial. Disa komuna i kanë plotësuar këto baza ligjore sipas disa kushteve specifike. AIL jepet për 12 muaj, dhe më pas mund të rinovohet.

LISTA E KOMUNAVE
DHE MËNYRA
APLIKIMIT TË AIL

🌐 [vd.ch > Thèmes > Aides financières et soutien social > Aides financières et comment les demander](#)



4.3 NDARJA E MBETJEVE

PËR TË RUAJTUR MJEDISIN

Zvicra është një nga vendet evropiane me prodhimin më të rëndësishëm të mbetjeve për frymë. Për këtë arsye, është thelbësore që sistemi i menaxhimit të mbetjeve të jetë efikas. Kjo shmang ndotjen e mjedisit dhe të gjitha shqetësimet e tjera që lidhen me depozitimin e mbetjeve «të egra».

Në Zvicër, afërsisht dy të tretat e mbetjeve përbëhen nga materiale që mund të riciklohen. Ky është veçanërisht rasti për qelqin, kartonin, aluminin, disa plastika të caktuara dhe mbetjet organike. Këto të fundit përbajnë më shumë se gjysmën e peshës së tyre në ujë dhe për këtë arsye preferohet të mos digjen. Ndarja e mbetjeve tuaja ju kursen para dhe mbron mjedisin. Për këtë arsye, është thelbësore të respektoni informacionet që vijnë në këtë kapitull. Shumica e komunave praktikojnë “taksën e qeseve”. Banorët/et duhet të blejnë qese mbeturinash të taksuara në dyqane dhe ftohen të bëjnë ndarjen e mbetjeve të tyre me qëllim ruajtjen e mjedisit. Në disa bashki, taksa nuk vendoset për qesen e plehrave, por është një taksë peshe.

Qeset e mbeturinave të taksuara duhet të përdoren për mbeturinat shtëpiake (jo të riciklueshme) dhe të vendosen në kazanët e vendosur në zonën e banimit.

Mbetjet e riciklueshme, të rënda ose të rrezikshme hidhen pa pagesë nëse shkonin në qendrën e riciklimit më të afërt me shtëpinë tuaj. Për të pasur akses në të, në disa bashki, duhet të kërkonin (qoftë në Kontrollin e banorëve ose në portalin e internetit të bashkisë) një formular për të marrë një kartë personale që ju jep akses në qendrën e grumbullimit të mbetjeve.

Disa komuna organizojnë një grumbullim mujor të mbetjeve të mëdha dhe shpërndajnë një kalendar me datat e grumbullimit në fjalë.

Shumica e ndërtesave / lagjeve kanë kazanë për asgjësimin e qelqit, letrës dhe mbetjeve organike. Në përgjithësi qendrat tregtare mbledhin alumin, PET dhe bateri të përdorura.

Pajisjet elektronike mund të kthehen pa pagesë dhe pa detyrim blerje në çdo pikë shitje të këtyre pajisjeve (kompjuter, celular, televizor, elektroshtëpiake, hi-fi, etj.).

KONTROLLI I BANORËVE TË KOMUNËS SUAJ OSE KONSULTONI FAQEN

 vd.ch > Thèmes > Environnement > Déchets

🔔 INFORMACION I NEVOJSHËM

Disa bashki ofrojnë përjashtim nga taksa e qeseve në kushte të caktuara (për shembull për familjet ose personat me të ardhura të pakta).

4.4 DISA RREGULLA BASHKËJETESE NË KOMUNITET

BASHKËJETESA

Sidomos në ndërtesat me qira me shumë apartamente, është e rëndësishme të ruani marrëdhënie të mira me fqinjët. Është e nevojshme në veçanti:

- ➔ Të respektoni fqinjët duke shmangur, për shembull, zhurmën të dielave dhe në mbrëmje pas orës 22:00, gjithashtu duke respektuar pronën e tyre private si dhe ambientet e përbashkëta.
- ➔ Mos parkoni në vende «Vizitorët».
- ➔ Respektoni orarin e vendosur për përdoruesit/et e dhomës së lavanderisë dhe sigurohuni që ajo të rregullohet dhe pastrohet pas përdorimit.
- ➔ Hidhni mbeturinat tuaja në vendin e caktuar dhe bëhuni pjesë e ndarjes selektive.
- ➔ Sigurohuni që kafshët tuaja shtëpiake të mos shqetësojnë lagjen me zhurmat e tyre dhe të mos ndotin zonat e përbashkëta.

ROLI I MIRËMBAJTËSIT

Mirëmbajtësi/ja ose kujdestari/ja i ndërtesës luan një rol thelbësor në funksionimin e duhur të një godine. Ai ose ajo siguron që rregullorja dhe rregullat e sigurisë së ndërtesës në bashkëpronësi të respektohen. Njëkohësisht, ai ose ajo kujdeset për mirëmbajtjen e ambjenteve të përbashkëta të ndërtesës. Ai ose ajo shërben gjithashtu si person kontakti dhe ndërmjetës midis banorëve dhe bashkëpronarëve dhe ju mund ta kontaktoni, pa hezitim, për çdo pyetje që lidhet me vendbanimin tuaj.

Nëse ndërtesa juaj nuk ka një mirëmbajtës, mund të kontaktoni agjensinë tuaj.

📌 KËSHILLA

Festa e Fqinjëve organizohet të martën e fundit të muajit maj në lagje të caktuara të disa komunave në Vaud. Kjo është një mundësi për t'u njohur me banorët/banoret e lagjes suaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

📄 10 Koha e lirë dhe jeta sociale

SHËNIME

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and extend across the width of the page. There are no margins or other markings on the paper.



5 SIGURIMET, NDIHMAT SOCIALE DHE TAKSAT

5.1	SIGURIMET SHOQËRORE	50
5.2	SIGURIMET SHËNDETËSORE	51
5.3	SISTEMI ME TRI SHTYLLA DHE SIGURIMI PËR PAPUNËSINË	55
5.4	SIGURIME NË LIDHJE ME LINDJEN DHE FËMIJËT	57
5.5	NDIHMA SOCIALE	58
5.6	SIGURIME TË TJERA	61
5.7	TAKSA	62

5.1 SIGURIMET SHOQËRORE

SIGURIMI NË ZVICËR

Shumica e sigurimeve shoqërore janë të detyrueshme. Ato u mundësojnë punëtorëve/eve dhe familjeve të tyre që kanë kontribuar në pagat e tyre, të kenë të ardhura të caktuara në rast të ndërprerjes së punës, në rastet e sëmundjeve ose papunësisë, për shembull. Ato administrohen kryesisht nga punëdhënësi/ja (përveç sigurimit shëndetësor!).

Sistemi zviceran i sigurimeve shoqërore përfshin disa lloje sigurimesh :

- ➔ Sigurimi i pleqërisë dhe i mbijetesës, sigurimi i aftësisë së kufizuar dhe përfitimet suplementare federale (AVS, AI dhe PC: shtylla e parë).
- ➔ Pensioni profesional (LPP: Shtylla e 2-të).
- ➔ Shtesat për humbjen e të ardhurave në rast të shërbimit ushtarak, shërbimit civil, mbrojtjes civile, shtesës së lindjes dhe pushimit të atësisë (APG).
- ➔ Sigurimi për papunësinë (UI).
- ➔ Shtesat familjare (LAFam).
- ➔ Sigurimi shëndetësor dhe aksidenti (LA-Mal dhe LAA).

Në kantonin e Vaud-it, agjensitë e sigurimeve shoqërore (AAS) janë në dispozicionin tuaj për t'ju informuar dhe udhëzuar për të drejtat dhe detyrimet tuaja në lidhje me sigurimet. Ekzistojnë disa agjensi për çdo rajon. Për të gjetur atë që i përgjigjet banesës suaj, konsultoni faqen e mëposhtme.

GJENI NJË AGJENSI SIGURIMESH SHOQËRORE PRANË BANESËS TUAJ

 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Aides financières et soutien social > Trouver une agence d'assurance sociale (AAS)

MË SHUMË INFORMACIONE

 3.3 Kam një punë

Ju gjithashtu mund të kontaktoni drejtpërdrejt me punëdhënësin/en tuaj.

SIGURIMI BAZË SHËNDETËSOR (LAMdI)

Sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm në Zvicër. Ju duhet të keni një të tillë, jo më vonë se 3 muaj pas mbërritjes tuaj. Nëse nuk e bëni këtë brenda 3 muajve, do t'ju tarifohen shpenzime shtesë. Sigurimi do të hyjë në fuqi sapo të merrni vendbanimin. Këshillohet që ta bëni këtë sa më shpejt të jetë e mundur që të mos ju duhet të paguani 3 muaj sëbashku.

Ekziston një dallim midis sigurimit shëndetësor bazë, i cili është i detyrueshëm, dhe sigurimit shëndetësor shtesë, i cili nuk është i detyrueshëm dhe mbulon shpenzimet e tjera mjekësore, si shpenzimet mjekësore të udhëtimit, shpenzimet e mjekësisë alternative, hospitalizimet private ose gjysmë private, etj. Ka disa pu-



KUJDES

Ju gjithashtu duhet të bëni një sigurim në rast aksidenti, nëse tashmë, nuk ju mbulon punëdhënësi/ju juaj nga sigurimi i aksidenteve.

nonjës sigurimi shëndetësor në kantonin e Vaud-it, zgjidheni një, lirisht. Ky i fundit ka detyrimin t'ju pranojë për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, pavarësisht nga mosha dhe gjendja juaj shëndetësore.

Si person i siguruar, ju do të paguani një shumë mujore sigurimi i cili nuk varet nga të ardhurat tuaja, por që varion sipas shumës së tarifës suaj. Nga ana tjetër, në varësi të të ardhurave tuaja dhe madhësisë së familjes suaj, ju mund të përfitoni nga një subvencion (shiko më poshtë). Tarifa është pjesë e shpenzimeve tuaja mjekësore që ju do të duhet të paguani përveç primeve. Në varësi të formulës që keni zgjedhur, tarifa është një shumë midis 300 dhe 2500 frangash të cilat do të duhet të paguhen nga ju çdo vit, si kontribut për kostot e trajtimit tuaj. Pasi të arrihet kjo shumë, sigurimi juaj shëndetësor do të mbulojë 90% të kostove që tejkalojnë tarifën tuaj vjetore. 10% i mbetur do të jetë përgjegjësia juaj deri në një shumë vjetore prej 700 frangash.

Përsa i përket tarifës, ju keni mundësi për të paguar 2500 franga, 2000 franga, 1500 franga, 1000 franga, 500 franga, ose 300 franga, në vit. Megjithatë, duhet të keni parasysh se sa më i ulët të jetë tarifa juaj vjetore (tarifa), aq më i lartë është kontributi juaj mujor i sigurimit (primi). Prandaj është e nevojshme të siguroheni që tarifa e për zgjedhur të përshtatet me financat tuaja, por edhe me gjendjen tuaj shëndetësore.

Nëse keni nevojë të ndiqni një trajtim të rregullt mjekësor që gjeneron kosto të konsiderueshme çdo vit, një tarifë e vogël ndoshta do të jetë më e përshtatshme. Nëse, nga ana tjetër, gëzoni shëndet të mirë dhe rrallë shkoni te mjeku, një tarifë e lartë mund të jetë më favorshme. Në këtë rast, do të ishte e rëndësishme të kishit rezerva të mjaftueshme financiare për të përballuar kostot e paparashikuara mjekësore: papritmas, nëse duhet të paguani 2500 franga, kjo mund t'ju çojë në rrezik borxhi.

Kompanitë e sigurimeve operojnë sipas dy sistemeve shumë të ndryshme përsa i përket mbulimit të shpenzimeve mjekësore. Sistemi i parë është i ashtuquajtur «garant i palës së tretë»: personi i siguruar i paguan vetë faturat dhe rimburohet nga fondi i tij, pasi të jetë arritur shuma vjetore e tarifës. Sistemi i dytë është i ashtuquajtur sistemi i «pagesave nga palët e treta»: fondi e merr faturën drejtpërdrejt dhe paguan fatura të caktuara nga vetë ofruesit e kujdesit shëndetësor. Personi i siguruar rimburohet vetëm sa është tarifa dhe pjesëmarrjen e tij në kosto. Në mënyrë që sigurimi të jetë në përputhje me financat tuaja, është e rëndësishme të merrni parasysh këto dy sisteme të ndryshme të mbulimit të shpenzimeve mjekësore kur zgjidhni se cilin sigurim do të merrni

LLOGARITËSI I PRIMEVE 2021

 priminfo.admin.ch

Kushtet e kontributit ndryshojnë çdo vit dhe është e mundur që të ndryshoni sigurimin shëndetësor duke dërguar një letër anulimi me letër rekomande, përpara fundit të muajit nëntor. Është thelbësore t'u keni paguar agjensisë siguruese tuaj aktuale të gjitha faturat (primet dhe kontributet) deri më 31 dhjetor, në mënyrë që të keni mundësi të ndryshoni siguruesin shëndetësor vitin e ardhshëm.

PRIMET DHE NDRYSHIMI I FONDIT TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR

 ch.ch/fr/aide-memoire-primet-et-changement-de-caisse-maladie

SIGURIMI SHËNDETËSOR NË RAST SHTATZËNIE DHE TË POSALINDURI

Gjatë ndjekjes së shtatzënisë, në rast problemesh shëndetësore, shpenzimet e zbritshme nuk janë përgjegjësia juaj, nga java e 13-të e shtatzënisë deri në javën e 8-të pas datës së lindjes së fëmijës suaj.

SHTATZËNIA – PËRFITIMET E SIGURIMIT SHËNDETËSOR

 ch.ch/fr/grossesse-prestations-assurance-maladie

Është thelbësore të regjistroni foshnjat e posalindura me sigurim shëndetësor gjatë shtatzënisë dhe deri në muajin e tretë pas lindjes.

SIGURIMI SHËNDETËSOR PËR FËMIJËN TUAJ

 ch.ch/fr/assurance-maladie-bebe

PËRFUNDIMI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR NË RAST ZHVENDOSJE

Nëse largoheni nga Zvicra, ju jeni i detyruar të ndërprisni sigurimin shëndetësor. Për ta bërë këtë, ju duhet të kërkonti një certifikatë largimi nga komuna juaj dhe t'ia paraqisni atë siguruesit tuaj në mënyrë që ai të mund të ndërpresë kontratën tuaj të sigurimit.

Nëse dëshironi që sigurimi juaj shëndetësor të mbulojë përfitime që nuk mbulohen nga sigurimi bazë, ka një shumëllojshmëri të gjerë sigurimesh suplementare. Për shembull, ju mund të përfitoni nga më shumë shërbime mjekësore ambulatorë (korrigjim i dhëmbëve për fëmijët, trajtime mjekësore plotësuese si osteopatia), të keni më shumë rehati, të zgjidhni lirisht mjekun tuaj gjatë qëndrimit në spital, etj. Sigurimi suplementar nuk është sigurim shoqëror dhe nuk është i detyrueshëm. Një ndryshim kryesor nga sigurimi bazë është se sigurimet nuk mund t'i pranojnë të gjithë. Ata gjithashtu mund të vendosin primet sipas moshës tuaj, gjendjes tuaj shëndetësore, gjinisë tuaj dhe t'ju kërkojnë që të plotësoni një pyetësor shëndetësor përpara se të pranoni t'i bashkoheni një sigurimi plotësues.

Prandaj, kushtet e anëtarësimit tuaj në sigurimin e dëshiruar varen nga përgjigjet tuaja në lidhje me shëndetin tuaj. Plotësoni pyetësin në kujdes, sepse kompania e sigurimeve shëndetësore mund të rishqyrtojë më vonë kushtet e sigurimit, apo edhe anëtarësimit tuaj në këtë sigurim, nëse të dhënat që keni dhënë ishin të paplota.

Nëse dëshironi të lidhni një ose më shumë sigurime shtesë për fëmijën tuaj, është mirë ta bëni këtë përpara se fëmija të lindë. Në rast njoftimi para lindjes, shpeshherë sigurvearit shëndetësorë garantojnë sigurimin e fëmijës pa kushte dhe pa pyetësor shëndetësor. Specialistët e menaxhimit të buxhetit në përgjithësi këshillojnë që fëmijët të sigurohen në paketa suplementare për trajtimin e dhëmbëve (korrigjimi i dhëmbëve), pasi këto trajtime mund të jenë shumë të shtrenjta. Duhet gjithashtu të lidhni një sigurim të tillë në kohë. Pas një moshe të caktuar, sigurvearit shëndetësorë kërkojnë paraprakisht një ekzaminim dentar.



KUJDES

Ju mund të aplikoni për subvencione direkt në internet ose, nëse keni nevojë për ndihmë, mund të kontaktoni agjensinë e sigurimeve shoqërore në rajonin tuaj. Ata do t'ju ndihmojnë të plotësoni formularët.

Kjo mbështetje është falas. Prandaj nuk është e nevojshme të përdorni ndonjë shërbim me pagesë. Kompanitë që i ofrojnë ato nuk janë të mandatuara nga shteti i Vaud-it. Përdorimi i ndërmjetësve të tillë përbën një rrezik të trefishtë: të sillni një person të panjohur në shtëpinë tuaj, t'i jepni atij informacione konfidenciale në lidhje me situatën tuaj financiare dhe mund t'ju ofrojnë produkte sigurimi të padëshirueshme.

Sigurimet suplementare shpesh ofrojnë një sërë përfitimesh dhe nuk kufizohen në një përfitim të vetëm. Prandaj, nëse vendosni të bëni sigurim shtesë, kontrolloni që të mos jeni i siguruar dyfish për të njëjtin përfitim.

LISTA E AGJENSIVE TË OVAM-IT SIPAS RAJONIT

🌐 vd.ch > Aides
financières et soutien
social > Trouver une
agence d'assurance sociale (AAS)



SIGURIMI NGA AKSIDENTI (LAA)

Synimi i LAA është të mbulojë shpenzimet ekonomike të aksidenteve profesionale dhe joprofesionale. Punonjësit që punojnë më shumë se 8 orë në javë janë të siguruar nga punëdhënësi/ja i tyre kundër aksidenteve joprofesionale. Përndryshe, ky sigurim aksidenti duhet të paguhet në sigurimin tuaj shëndetësor.

SUBVENCIONET (ASISTENCA FINANCIARE)

Nëse keni vështirësi në pagesën e tarifës tuaj, Office vaudois de l'assurance maladie (OVAM) mund t'ju ndihmojë dhe të paguajë një subvencion, tek siguruesit tuaj shëndetësor. Kjo shumë varet nga të ardhurat tuaja. Aplikimi duhet të dorëzohet në agjensinë e rajonit tuaj të banimit ose në internet.

OFFICE VAUDOIS DE L'ASSURANCE-MALADIE

📍 Chemin de Mornex 40
1014 Lausanne

🌐 vd.ch > Thèmes > Santé, soins et handi-
cap > Assurance-maladie >
Subside à l'assurance-maladie

🔔 INFORMACION I NEVOJSHËM

Subvencionet fillojnë në momentin e aplikimit, kështu që, ju duhet të aplikoni sapo të ulen mundësitë tuaja financiare. Në të kundërt, nëse keni të drejtë për subvencione dhe gjendja juaj financiare përmirësohet, duhet të njoftoni drejtpërdrejt OVAM-in në mënyrë që të mos keni nevojë të paguani një faturë të mëparshme.

5.3 SISTEMI ME TRI SHTYLLA DHE SIGURIMI PËR PAPUNËSINË

AVS, AI DHE PËRFITIMET PLOTËSUESE FEDERALE: SHTYLLA E 1-RË

Sigurimi i pleqërisë dhe i mbijetesës (AVS) u mundëson të gjithë personave që banojnë në Zvicër të marrin të ardhura bazë pas daljes në pension.

Sigurimi i invaliditetit (AI) mbulon dëmtimin e shëndetit që ka ndikim në kapacitetet përfituese gjatë karrierës profesionale.

Për punëtorët/punëtoret, një pjesë e kontributeve në këto sigurime u zbritet nga paga dhe një pjesë tjetër paguhet nga punëdhënësi/ja. Personat që nuk janë të punësuar me rrogë duhet gjithashtu të paguajnë një kontribut vjetor. Kontributi minimal është vendosur në 496 franga.

Përfitimet suplementare (PC) u ofrohen personave që banojnë në Zvicër, të cilët marrin një pension AVS ose AI dhe të ardhurat e tyre nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat bazike. Të huajt duhet të plotësojnë disa kërkesa shtesë. Dorëzimi i një aplikimi për PC është falas dhe bëhet pranë agjensive të sigurimeve shoqërore. PC-të përbëjnë, së bashku me AVS-në dhe UA-në, të parën nga tri shtyllat e sistemit tonë të pensioneve.

Një certifikatë sigurimi AVS dhe AI, e paraqitur në formatin e kartës së kreditit, i lëshohet kujtdo që punon ose paguan kontribute. Kjo kartë është dëshmi që ju

jeni të siguruar me AVS/AI. Ajo duhet t'i jepet çdo punonjësi/e të re dhe mund t'ju kërkohet për procedura të tjera.

PENSIONI PROFESIONAL: SHTYLLA E 2-TË

Planet e pensioneve profesionale synojnë t'u mundësojnë personave që kanë mbushur moshën e pensionit, të mbijetuarve dhe personave me aftësi të kufizuara të kenë të ardhura. Ai funksionon si plotësues i pensionit AVS ose AI (shtylla e 1-rë).

Është i detyrueshëm për punonjësit/et që marrin më shumë se 21,330 franga në vit dhe jo i detyrueshëm për të vetëpunësuarit/at. Të gjithë punëdhënësit/et duhet të sigurojnë personelin e tyre në institucionin e sigurimit të kompanisë dhe duhet të mbulojnë të paktën gjysmën e kontributeve.

SIGURIMI I JETËS APO KURSIMI INDIVIDUAL: SHTYLLA E 3-TË

Është gjithashtu e mundur, në varësi të nevojave dhe mundësive tuaja, të kontribuoni në sigurimin e jetës (shtylla e 3-të) me një kompani sigurimesh ose një bankë private. Shtylla e tretë mund të jetë edhe në formën e kursimeve individuale. Kontributet e shtyllës së 3-të mund të zbriten nga taksat tuaja deri në një shumë vjetore maksimale, e cila mund të ndryshojë nga viti në vit.

PAGESA PËR HUMBJE TË TË ARDHURAVE (SHËRBIMI USHTARAK, PUSHIM I LINDJES OSE ATËSISË)

Për çdo ditë shërbimi në ushtrinë zvicerane, mbrojtjen civile ose Kryqin e Kuq, si dhe për pushimin e lindjes dhe pushimin dyjavor të atësisë, ju keni të drejtën e «ndihmave për humbjen e të ardhurave» (APG).

Kjo mbështetje financiare do t'ju paguhet nga punëdhënësi/ja nëse jeni punonjës/e ose nga fondi i kompensimit të Vaud nëse nuk kryeni aktivitete fitimprurëse.

PËR TË PAVARURIT – CAISSE CANTONALE VAUDOISE DE COMPENSATIONS AVS

 caisseavsvaud.ch > Particuliers >
Prestations APG/AMat/APat/APC

SIGURIMI I PAPUNËSISË

Sigurimi i papunësisë zbritet nga paga e të gjithë punëtorëve/eve. Kjo ju lejon të merrni kompensim në rast se largoheni ose humbni punën tuaj.

Për të pasur të drejtën e sigurimit të papunësisë, është e nevojshme të keni punuar të paktën 12 muaj në 2 vitet para datës së aplikimit. Gjithashtu, në rastin kur punonjësi/ja largohet vullnetarisht nga puna, parashikohen penalitete dhe shuma e sigurimit është më e vogël se në rastin e një largimi nga puna, që mund të përfshijë dëmshpërblime disamujore të papaguara.



KUJDES

Për evropianët ose evropianet që janë shtetas/e të një shteti anëtar të BE-së ose EFTA-s, në kushte të caktuara, përdorimi i përfitimeve shtesë ndaj AVS ose AI, mund të jetë një shkak për revokimin e një leje qëndrimi të marrë në kontekstin e një qëndrimi pa aktivitet fitimprurës.

Për shtetasit e një vendi të tretë, marrja e përfitimeve shtesë të AVS ose AI mund të përbëjë pengesë për një aplikim për bashkim familjar.

5.4 SIGURIME NË LIDHJE ME LINDJEN DHE FEMIJËT

SIGURIMI I LINDJES

Punëtorët femra kanë të drejtë, pas lindjes së fëmijës, për leje lindje prej të paktën 14 javësh.

➔ Gjatë pushimit të lehonisë, punëtorja ka të drejtën e pagesës së 80% të pagës së saj, në formë shpërblimi ditor.

➔ Për të marrë përfitimet e lindjes, duhet të keni qenë i siguruar për AVS gjatë 9 muajve para lindjes dhe të keni punuar për të paktën 5 muaj gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu merren parasysh edhe periudhat e sigurimit dhe të punës në një vend të BE/EFTA. Në rrethana të caktuara, gratë që nuk i plotësojnë këto kushte mund të marrin një ndihmë kantonale të lindjes.

PAGESAT PËR FËMIJËT

Mbështetja familjare zvicerane gjithashtu jep të drejtën e ndihmës familjare (mbështetje financiare) për çdo fëmijë. Këto shtesa paguhen nga punëdhënësi/ja, ose për personat pa punë fitimprurëse, nga fondi i kompensimit të kantonit Vaud. Shtesat familjare nuk paguhen automatikisht, por vetëm me kërkesë.

INFORMACION LIDHUR ME LETËSIMET E FËMIJËVE

🌐 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes > Aides financières et soutien social > Aides financières et comment les demander > Allocations familiales



SIGURIMI I ATËSISË

Leja e atësisë jep dy javë për baballarët brenda 6 muajve nga lindja e fëmijës së tyre. Pushimi mund të merret menjëherë (përfshirë fundjavën) ose në formën e ditëve. Babai duhet të ketë qenë i siguruar në mënyrë të detyrueshme në AVS gjatë 9 muajve menjëherë para lindjes dhe të ketë punuar për të paktën 5 muaj.

Për sa i përket pushimit të lindjes, shumata korrespondon 80% të të ardhurave mesatare nga punësimi fitimprurës të marra para lindjes së fëmijës, por në maksimum 196 franga në ditë. Për dy javë, baballarët mund të marrin një sasi maksimale prej 2744 frangash.

5.5 NDIHMAT SOCIALE

SHKURTIMISHT

Në të gjithë kantonin e Vaud-it, qendrat sociale rajonale u ofrojnë të gjithë njerëzve që banojnë në komunën e Vaud-it informacion, këshilla dhe mbështetje në rast të vështirësive financiare, sociale ose familjare.

Nëse ky është rasti juaj, mund të shkoni në Centre social régional (CSR) që është më afër me shtëpinë tuaj. Profesionistët do t'ju ndihmojnë për të gjitha pyetjet tuaja që lidhen, mbi të gjitha, me marrjen e të ardhurave nga integrimi, ri-integrimi profesional etj.

GJENI CENTRE RÉGIONAL SOCIAL (CSR), MË TË AFËRT

 vd.ch > Thèmes > Aides financières et soutien social > Trouver un centre social régional (CSR)



KUJDES

Marrja e ndihmave sociale mund të ndikojë në lejen e qëndrimit dhe rinovimin e saj. Në të vërtetë, nga një shumë e caktuar, personat që posedojnë një leje qëndrimi në Zvicër mund ta humbasin atë ose të hasin probleme gjatë rinovimit të saj.

PC FAMILLES

Përfitimet suplementare kantonale për familjet (PC Familles) janë të destinuar për familjet me fëmijë nën 16 vjeç, të cilët punojnë dhe që nuk janë në gjendje të mbulojnë nevojat thelbësore të familjes së tyre. Falë kësaj mbështetjeje financiare, familjet në fjalë nuk kanë nevojë të përdorin asistencë sociale dhe mund të mbajnë apo edhe të rrisin aktivitetin e tyre fitimprurës.

Përfitimet suplementare për familjet përbëhen nga një përfitim financiar mujor dhe rimbursimi i shpenzimeve të kujdesit për fëmijët dhe sëmundjeve të vërtetuara.

Për të marrë PC-të e familjes, mund të shkoni në Centre régional de décisions PC Familles (CRD) nga e cila varet komuna juaj e banimit për të plotësuar formularin e aplikimit. Këto organizma do t'ju ofrojnë informacion dhe do t'ju ndihmojnë të krijojnë një dosje.

GJENI CENTRE
RÉGIONAL DE
DÉCISIONS,
MË TË AFËRT

 vd.ch > Thèmes >

Aides financières et soutien social >
Aides financières et comment les
demander > PC Familles



KUSHTET PËR TË PËRFITUAR NGA PC FAMILLES

- ➔ Të jeni banor në kantonin e Vaud për të paktën 3 vjet dhe të keni një leje qëndrimi të vlefshme
- ➔ Të jetoni në një familje të përbashkët me fëmijët nën moshën 16 vjeç
- ➔ Të keni të ardhura të pamjaftueshme në lidhje me shpenzimet familjare, sipas standardeve të përcaktuara në ligjin për përfitimet suplementare kantonale për familjet (LPCFam)

Centre social régional

Bex

 Avenue de la Gare 14
1880 Bex
 024 557 27 27
 csr.bex@vd.ch

Échallens

 Rue des Champs 5
1040 Échallens
 021 622 75 55
 csr@araspe.ch

Perëndim Lausanne-Oron-Lauvaux – Siti i Pully

 Avenue de Villardin 2
1009 Pully
 021 557 84 00
 csr.pully.info@aras.vd.ch

Perëndim Lausanne-Oron- Lauvaux – Siti i Oron

 Le Bourg 11
Case postale 54 | 1610 Oron-la-Ville
 021 557 19 55
 csr.oron.info@aras.vd.ch

Junova

📍 Rue des Pêcheurs 8A
1400 Yverdon-les-Bains
📞 024 557 76 76
@ csr.junova@aras.vd.ch

Morges-Aubonne-Cossonay

📍 Rue de Couvaloup 10
Case postale 982 | 1110 Morges 1
📞 021 804 98 98
@ csr.morges@aras-vd.ch

Moudon

📍 Place Saint-Etienne 6
1510 Moudon
📞 021 557 86 80
@ csr.broye-vully@vd.ch

Nyon

📍 Rue des Marchandises 17
1260 Nyon
📞 021 338 99 38
@ csr.nyon@vd.ch

Ouest lausannois

📍 Avenue du 14-Avril 8
1020 Renens
📞 021 316 84 00/01/02
@ csr.ouest-lausannois@vd.ch

Penthalaz

📍 Place Centrale 5
1305 Penthalaz
📞 021 622 75 55
@ csr@araspe.ch

Payerne

📍 Rue des Terreaux 1
Case postale 144 | 1530 Payerne
📞 026 557 30 50
@ csr.broye-vully@vd.ch

Prilly

📍 Rue des Métiers 1
1008 Prilly
📞 021 622 74 00
@ csr@araspe.ch

Riviera – Siti i Montreux

📍 Avenue Claude-Nobs 14
Case postale 1009 | 1820 Montreux 1
📞 021 962 78 60
@ csrriviera@arasriviera.ch

Riviera – Siti i Vevey

📍 Rue du Collège 17
Case postale 1112 | 1800 Vevey
📞 021 925 53 33
@ csrriviera@arasriviera.ch

Service social Lausanne

Informacione Sociale
Shërbimi social
📍 Place Chauderon 4
Case postale 5032 | 1002 Lausanne
📞 021 315 75 11
@ ssl@lausanne.ch

SIGURIMI NGA ZJARRI DHE FENOMENET NATYRORË (ECA)

Sigurimi nga zjarri dhe fenomenet natyrorë për pasuritë tuaja të luajtshme dhe të paluajtshme është i detyrueshëm te ECA në kantonin e Vaud-it.

MË SHUMË INFORMACIONE

Établissement cantonal d'assurance

📍 Avenue du Grey 111

Case postale | 1002 Lausanne

📞 058 721 21 21

SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË CIVILE (RC)

Sigurimi i përgjegjësisë civile (RC) ju mundëson të siguronit shtëpinë dhe sendet tuaja kundër çdo dëmtimi, përfshirë ato të shkaktuara pa dashje nga fëmijët tuaj ose nga ju vetë. Ky sigurim është i rekomanduar, por jo i detyrueshëm. Megjithatë, ky sigurim mund të jetë i detyrueshëm për të gjetur një banesë, siç e kërkojnë autoritete të ndryshme.

SIGURIMI I AUTOMJETIT

Sigurimi i mjeteve motorike, i cili është i detyrueshëm, ju lejon të siguronit makinën/motoçikletën tuaj kundër të gjitha dëmeve të kryera nga ju ose një përdorues/e tjetër në rrugë.

SIGURIM I SPECIALIZUAR

Në varësi të nevojave tuaja, ekzistojnë sigurime të tjera : për kafshë, udhëtime, përgjegjësi ligjore, etj. Shumë kompani private sigurimesh ofrojnë këto shërbime. Në internet ka krahasime të ndryshme të ofertave të sigurimit.

KONFLIKTE ME SIGURIMIN TUAJ?

Fondacioni Ombudsman për sigurimin dhe i Suva-s mund t'ju mbështesin në mosmarrëveshjet me kompaninë tuaj të sigurimit. Zyra e ndërmjetësimit ndërhyr pa pagesë për të siguruarin dhe shqyrton me shpejtësi mosmarrëveshjet sipas ligjit të sigurimeve.

MË SHUMË INFORMACIONE

Fondation Ombudsman

📞 076 651 41 65

🌐 ombudsman-assurance.ch

5.7 TAKSAT

TAKSAT

Ju i nënshtroheni taksave në kantonin e Vaud-it sepse jetoni në një komunë të kantonit ose sepse elementë të tjerë ju bashkojnë aty (qëndrimi, pronësia, veprimtaria e pavarur, etj.). Ekzistojnë dy mënyra të taksimit:

- ➡ Tatimi në burim (leja B, L, F, N, Ci...). Punëdhënësi/ja juaj zbret drejtpërdrejt taksat nga paga juaj.
- ➡ Deklarata vjetore (leja C dhe shtetasit/et zviceranë).

🔔 INFORMACION I NEVOJSHËM

Në parim, personat me leje B taten në burim, por në disa raste duhet të plotësojnë një deklaratë vjetore.

Ju duhet të plotësoni deklaratën tuaj tatimore çdo vit (e mundur dhe nga interneti). Ju mund të paguani këtë mujore për atë që fitoni sot, për të shmangur detyrimin për të paguar taksat menjëherë kur të merrni tatimin vitin e ardhshëm. Administrata tatimore kantonale (ACI) është aty për t'ju ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm mbi këtë çështje.

AVIVO PERMANENCES IMPÔTS

🌐 avivo-vaud.ch > Permanences

ADMINISTRATION CANTONALE DES IMPÔTS (ACI)

📍 Route de Berne 46
1014 Lausanne
📞 021 316 00 00
✉ info.aci@vd.ch
🌐 vd.ch/impots

PROCEDURAT DHE AFATET


Punonjësit/et pa aktivitet apo të ardhura, përfitues të sigurimit të papunësisë, praktikant/e, student/e, dhe çdo person (nga 18 vjeç) ka detyrimin të paraqesë deklaratën tatimore çdo vit deri më 15 mars.

Çdo tatimpagues mund të kërkojë pa pagesë zgjatjen e afatit për paraqitjen e deklaratës tatimore online. Nëse nuk e dorëzoni deklaratën tuaj brenda afatit të lejuar, do të merrni një gjobë me një tarifë prej 50 frangash.

Nëse pavarësisht paralajmërimit, ju ende nuk e dorëzoni deklaratën tatimore, do të taksoheni automatikisht dhe organi tatimor do t'ju ngarkojë me gjoba.

LINJA TELEFONIKE PARLONS CASH!

Nëse keni një pyetje ose problem në lidhje me vështirësitë financiare (faturat e papaguara, posta nga zyra e prokurorisë, etj.) mund të kontaktoni linjën e ndihmës Vaud «Parlons Cash» nga e hëna në të enjte, ora 08:30 deri në orën 13:00, në numrin 0840 4321 00. Një punonjës social i specializuar në çështjet e parave mund t'ju përgjigjet dhe t'ju udhëzojë nëse keni nevojë, sigurisht falas.



6 SHËNDETI

6.1 KU DHE ME KË TË KONSULTOHEMI	64
6.2 PRINDËRIMI DHE LINDJA	68
6.3 DHUNA NË FAMILJE	71

6.1 KU DHE ME KË TË KONSULTOHEMI

SISTEMI SHËNDETËSOR ZVICERAN

Cilësia e kujdesit shëndetsor në Zvicër dhe në kantonin e Vaud-it njihet gjerësisht. Struktura të shumta spitalore, si dhe shumë mjekë janë në dispozicionin tuaj në rast të një problemi shëndetësor.

Brenda 3 muajve nga mbërritja juaj, ju duhet të bëni sigurimin shëndetësor. Kjo procedurë e detyrueshme është e rëndësishme sepse shërbimet mjekësore janë të shtrenjta në Zvicër. Me kartën tuaj të sigurimit, ju mund të shkoni tek mjeku, mjekja ose në spital dhe shpenzimet mjekësore do të mbulohen pjesërisht nga sigurimi juaj shëndetësor. Është gjithashtu e mundur të keni sigurim shëndetësor jo të detyrueshëm i quajtur “plotësues” i cili mbulon shërbime shtesë.

MË SHUMË INFORMACIONE

 5.2 Sigurimi shëndetësor

Disa konsulta të specializuara terapeutike (fizioterapi, ergoterapi, mjekësi natyrore) kërkojnë një recetë nga mjeku juaj i përgjithshëm për t'u rimbursuar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor. Në rast shtrimi në spital ose dyshime për përfitimet e mbuluara, është më mirë të konsultoheni fillimisht me sigurimin tuaj shëndetësor.



KUJDES

Shpenzimet për dhëmbët dhe syzet nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor!

GJETJA E NJË MJEKU/EJE

Në Zvicër, qytetarët përgjithësisht kanë një “mjek të familjes”. Është një mjek/e i përgjithshëm, që më pas mund të këshillojë një specialist, në varësi të nevojave. Për të gjetur një mjek/e ose një pediatër/e për fëmijën tuaj, mund të kontaktoni Société vaudoise de médecine (SVM). Ju gjithashtu mund të konsultoheni me faqen e internetit të Fédération suisse des médecins FMH.

MË SHUMË INFORMACIONE

Société vaudoise de médecine (SVM)

📍 Chemin de Mornex 38

Case postale 7443 | 1002 Lausanne

📞 021 651 05 05

@ info@svmed.ch

🌐 svmed.ch

Ju mund të konsultoheni me faqen e mëposhtme të internetit që specifikon gjuhën e folur nga mjekët.

MË SHUMË INFORMACIONE

Société vaudoise de médecine (SVM)

🌐 doctorfmh.ch

🔍 KËSHILLA

Mjeku juaj i familjes mund të vendoset sipas sigurimit të përzgjedhur ose duhet të zgjidhet nga një listë mjekësh të vendosur nga siguruesi. Mjeku i zgjedhur i familjes është më pas përgjegjës për ndjekjen mjekësore të personave të siguruar që e kanë zgjedhur atë. Ai ose ajo mund t'ju referojë më pas tek një specialist, në varësi të nevojave tuaja. Ju gjithashtu mund t'ju duhet të shkoni tek mjeku i përgjithshëm nëse dëshironi të rimbursoheni nga siguri.

ÇFARË TË BËJMË NË RASTE PROBLEMI SHËNDETËSOR?

1. Kontaktoni me mjekunt uaj

Duke qënë se ju keni një mjek familjar, ai ose ajo do të jetë personi që duhet të kontaktoni në rast sëmundjeje, një aksidenti mesatarisht të rëndë ose shqetësimi psikologjik. Ju gjithashtu mund të konsultoheni me farmacistin tuaj. Ju do të flisni me personin që ju njehtë mirë dhe që mund të vlerësojë gjendjen tuaj shëndetësore dhe të organizojë trajtimin tuaj.

2. Kontaktoni qendrën telefonike

Nëse nuk keni një mjek ose ai nuk përgjigjet, qendra e thirrjeve për mjekët në gati-shmëri ju përgjigjet 24/24, në numrin **0848 133 133** (tarifë lokale). Ky numër është i vlefshëm në të gjithë kantonin e Vaud-it. Qendra e thirrjeve përbëhet nga profesionistë shëndetësorë (infermierë) të trajnuar posaçërisht për t'ju përgjigjur thirrjeve. Njëri ose njëra prej tyre do të vlerësojë situatën tuaj, do t'ju këshillojë dhe do t'ju drejtojë në strukturat më të përshtatshme. Përveç kësaj, këta profesionistë do të jenë në gjendje t'ju përgjigjen në disa gjuhë.

3. Kontaktoni Centre médico-social

Nëse nuk jeni në gjendje të udhëtoni, Centre médico-social (CMS) ofron kujdes infermieror, ushqim në shtëpi dhe ndihmë për kujdesjeje në të gjitha rajonet e kantonit.

MË SHUMË INFORMACIONE

Association vaudoise d'aide et de soins à domicile (AVASAD)

📍 Avenue de Chavannes 37

1014 Lausanne

📞 021 623 36 36

@ info@avasad.ch

🌐 avasad.ch

🗨️ KËSHILLA

Nëse keni nevojë të shkoni tek mjeku/ja, dentisti/ja, spitali ose qendër, mund të telefononi Shërbimi I transporteve i Kryqit të Kuq të Vaud. Vullnetarët vënë në dispozicion automjetin e tyre privat dhe mund të thirren çdo ditë pune. Tarifat përfshijnë një shumë për shërbimin dhe më pas llogariten në bazë të distancës së përshkuar.

🌐 croixrougevaudoise.ch > J'ai besoin d'aide
> Transports de personnes à mobilité réduite

4. Kontaktoni shërbimet e urgjencës

Në rast urgjence kërcënuese për jetën, numri për të telefonuar është **144** (ambulancë). Numri 144 është i rezervuar për emergjenca të rrezikshme për jetën. Duhet të thirret vetëm nëse jeta juaj ose e të tjerëve është në rrezik dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme mjekësore dhe shëndetësore. Nëse është një urgjencë, por ju jeni në gjendje të lëvizni, do t'ju duhet të shkoni në spitalin më afër shtëpisë tuaj.

Duhet të theksohet se shërbimet e urgjencës kanë detyrimin të trajtojnë të gjithë njerëzit në një emergjencë kërcënuese për jetën, pavarësisht nga të ardhurat e tyre apo përkatësia e tyre në sigurimet shëndetësore.

TË DREJTAT E PACIENTIT

Për këshilla mbi procedurat në lidhje me shëndetin ose në rast konflikti me një terapist/e ose një siguries.

MË SHUMË INFORMACIONE

Organisation suisse des patients (OSP)

📍 CHUV | Chemin de Mont-Paisible 18
1011 Lausanne

📞 021 314 73 88

🌐 spo.ch

INFORMACION SHËNDETËSOR NË SHUMË GJUHË

Faqja e internetit e Kryqit të Kuq Zviceran ofron shumë informacione në fushën e shëndetësisë dhe broshura të shkarkueshme në 18 gjuhë. Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit:

🌐 migesplus.ch/fr

Një broshurë që paraqet «kryesoret e të drejtave të pacientëve» është në dispozicion me një përmbledhje në disa gjuhë, shihni faqen më poshtë.

MË SHUMË INFORMACIONE

🌐 vd.ch > Santé, soins et handicap >
Patients et résidents: droits et qualité
de soins > Les droits des patients

VARËSITË

Qendra Kombëtare e Kompetencës në fushën e varësive

Problemet e varësisë me substanca (duhani, alkooli, medikamentet ose droga) ose pa (hiperaktiviteti, lojrat e fatit dhe çrregullimet e të ngrënit) mund të prekin të gjitha popullatat në Zvicër. Portali zviceran i varësisë ofron ndihmë për njerëzit dhe familjet që vuajnë nga çdo problem i lidhur me varësinë.

 addictionsuisse.ch

PROMOVIMI I SHËNDETIT

Unisanté

Unisanté, qendra e mjekësisë së përgjithshme dhe e shëndetit publik në Lausanne, ofron, ndër të tjera, këshilla për promovimin dhe parandalimin në lidhje me shëndetin e banorëve të kantonit Vaud. Ky informacion është i disponueshëm në faqen e internetit të institucionit dhe ka të bëjë veçanërisht me dietën, aktivitetin fizik, duhanin dhe shëndetin seksual. Ofrohen gjithashtu depistime për sëmundjet kardiovaskulare, kancerin e gjirit dhe të zorrës së trashë.

 unisante.ch/fr > Promotion prévention

NUMRAT E URGJENCËS

Policia

 117

Zjarrfikës

 118

Ambulanca

 144

Intoksifikimi

Tox Info Suisse – Qendra zvicerane për informacionin toksikologjik

 145 ou 044 251 51 51

Të rinjtë

Pro Juventute – Linjë telefonike në ndihmë të fëmijëve dhe të rinjve

 147

Mjekët në linjë

 0848 133 133 (tarifë lokale)

Ju dëgjojmë

La Main Tendue – linjë telefonike 24 orë në 24 për personat që kanë nevojë të dëgjojnë për ndihmë dhe mbështetje.

 143 (0.20 fr. për thirrje)

Dhuna

Centre d'accueil MalleyPrairie – konsulta specifike mbi dhunën në çift 24orë/24.

 021 620 76 76

Shpëtimi ajror

Rega

 1414

6.2 PRINDËRIMI DHE LINDJA

PARA LINDJES

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së shtatzënisë, një gjinekolog/e edhe/ose një mami ofrojnë ndjekje dhe konsultime gjatë shtatzënisë. Shpenzimet përkatëse mbulohen nga sigurimi shëndetësor. Për të gjetur një të tillë, mund të kontaktoni shoqërinë mjekësore të Vaud ose grupin e mamive të pavarura të Vaud.

Linja telefonike

Linja telefonike e pavarur e mamive VD (nga ora 10:00 deri në 18:00 / 7 ditë në javë)

☎ 021 213 79 05

🌐 votresagefemme.ch

Mamitë e pavarura

🌐 hebamme.ch > Parents >

Votre sage-femme >

Sages-femmes indépendantes

Në dispozicionin tuaj janë edhe profesionistë të tjerë për t'ju informuar dhe këshilluar para dhe pas lindjes.

Fondation PROFA

Maternitetet e spitaleve Vaud dhe Fondacioni PROFA u ofrojnë nënave dhe baballarëve konsultime konfidenciale dhe falas me një këshilltarë të shëndetit seksual, një mami ose një punonjës/e social në qendrat e ndryshme rajonale të fondacionit PROFA. Për të gjetur qendrën

më të afërt me shtëpinë tuaj, mundeni të kontaktoni me telefon ose vizitoni faqen e tyre të internetit:

☎ 021 631 01 50

🌐 profa.ch/cp

Association PanMilar

Association PanMilar ofron kurse përgatitore për lindjen në disa gjuhë falë pranisë së përkthyesve të komunitetit. Faqja e tyre e internetit është përkthyer në më shumë se 30 gjuhë.

☎ 077 410 20 24

@ secretariat@panmilar.ch

🌐 pan-milar.ch

Association Appartenance

Association Appartenances ofron kurse të gjuhës franceze rreth temave « Shtatzënia, lindja dhe foshnjëria ».

Espace Femmes Vevey

📍 Rue des Communaux 2A

1800 Vevey

☎ 021 922 45 23

🌐 ef.vevey@appartenances.ch

Espace Femmes Lausanne

📍 Rue des Terreaux 10, kati 4

1003 Lausanne

☎ 021 351 28 80

@ ef.lausanne@appartenances.ch

PAS LINDJES

Për kujdesin e nënës dhe foshnjës, mami të pavarura të Vaud ju mbështesin dhe stërvisin gjatë gjithë shtatzënisë, dhe ju japin konsulta në shtëpi sapo të ktheheni nga materniteti. Më pas infermieret e fëmijërisë së hershme nga AVASAD dhe Prevention Space marrin përsipër dhe ofrojnë këshilla dhe informacione gjatë konsultimeve në shtëpi, takimeve pas lindjes ose seminareve/kurseve të ndryshme në grup.

Nëse dëshironi të përfitoni nga mbështetja e personalizuar nga një mami gjatë gjithë shtatzënisë, apo edhe pas lindjes së fëmijës tuaj, mund të gjeni dhe të kontaktoni një mami afër shtëpisë tuaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

 votresagefemme.ch > Changer la zone >
Pour le public > Rechercher
une sage-femme

Infermierët/et e fëmijërisë së hershme

Nëse dëshironi të përfitoni nga një vizitë në shtëpi nga një infermier/e e fëmijërisë së hershme AVASAD pas lindjes së fëmijës suaj, thjesht kontaktoni me ta në varësi të rajonit në të cilin jetoni.

Est vaudois

 021 925 09 80

La Côte

 021 804 66 40

Lausanne et région

 021 641 08 10

Nord vaudois-Broye

 024 420 31 15

 avasad.ch



KUJDES

Mos harroni të bëni sigurimin shëndetësor për fëmijën tuaj nga shtatzënia deri në muajin e tretë pas lindjes

-  5.2 Sigurimi shëndetësor
-  5.4 Sigurimet në lidhje me maternitetin dhe fëmijët

Espace prévention

Qendra rajonale e aftësive që punon në fushat e promovimit dhe parandalimit të shëndetit, veçanërisht në fushën e fëmijërisë së hershme.

 espace-prevention-lacote.ch

PanMilar

PanMilar u ofron familjeve emigrante mbështetje në shtëpi pas lindjes duke u siguruar familjeve një mami dhe një përkthyes. Sapo të kthehen në shtëpi, gratë që tashmë kanë marrë pjesë në klasat përgatitore për lindjen e fëmijëve do të mund të përfitojnë nga ndjekja e individualizuar në gjuhën e tyre, për t'i mbështetur ato gjatë kësaj periudhe të veçantë tranzicioni.

 077 410 20 24

 panmilar.ch > Post partum

Takime për baballarë dhe baballarët e ardhshëm

Shoqata maenner.ch me programin e saj MenCare Suisse romande ofron takime për baballarët e ardhshëm dhe baballarët e rinj – me fëmijët e vegjël – të cilat mundësojnë shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave lidhur me ardhjen e fëmijës, rolin e tij si baba dhe bashkëprindërimi (barazimi i jetës profesionale / private etj.).

- 📍 Route de Pierrefleur 63
1958 Uvrier
- ☎ 078 874 46 08
- @ cretienand@maenner.ch
- 🌐 maenner.ch/fr/rencontres-pour-les-peres-et-futurs-peres

INTIMITETI

Fondation PROFA

Për konsultime dhe këshilla mbi seksualitetin, kontracepsionin, ndërprerjen e shtatzënisë, testet për HIV/AIDS dhe IST (infeksionet seksuale të transmetueshme) dhe homoseksualitetin, konsultime për shëndetin seksual, Fondacionit PROFA është në dispozicionin tuaj. Këshilltarët dhe mjekët ju mirëpresin në takime, në tetë qendrat rajonale të kantonit. Ky shërbim zakonisht quhet planifikim familjar.

- ☎ 021 631 01 42
- 🌐 planning-vd.ch

MBËSHTETJE PSIKOLOGJIKE

Association Appartenances – CPM

Shoqata Appartenances ofron ndihmë të specializuar psikoterapeutike dhe psikiatrike për personat në vuajtje psikologjike të lidhura me emigrimin dhe/ose një histori lufte, torture ose një formë tjetër të dhunës kolektive. Këto konsultime psiko-terapeutike për emigrantët janë të disponueshme në disa gjuhë.

Shoqata ka tre qendra konsultimi në Lausanne, Vevey dhe Yverdon-les-Bains.

- 📍 Rue des Terreaux 10
1003 Lausanne
- ☎ 021 341 12 50
- @ cpm.lausanne@appartenances.ch
- 🌐 appartenances.ch

DHUNA

Njësia e mjekësisë kundër dhunës CHUV

Për këdo që ka pësuar një sulm të drejt-përdrejtë në integritetin e tij trupor, seksual ose psikologjik, Njësia e mjekësisë kundër dhunës (UMV e CHUV) ofron një konsultim mjeko-ligjor dhe referim në shërbime të specializuara.

MË SHUMË INFORMACIONE

- 🌐 6.3 Dhuna në familje

🗨 INFORMACION I NEVOJSHËM

Për problemet e çifteve ka informacion dhe linja telefonike të specializuara.

MË SHUMË INFORMACIONE

Ndihmë dhe këshilla për çiftet

- ☎ 0840 860 860
- @ info@problemedecouple.ch
- 🌐 problemedecouple.ch

SHKURTIMISHT

Dhuna në familje i referohet të gjitha akteve të dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda çiftit ose familjes. Dhuna është e ndaluar me ligj. Autori i dhunës mund të dëbohet nga shtëpia e përbashkët nga policia, dhe të detyrohet të ndjekë një intervistë socio-edukative. Shërbimet mbështetëse ofrojnë këshilla, pritje ose strehim të sigurt për viktimat, si dhe konsultime dhe programe për autorët që dëshirojnë të kërkojnë ndihmë.

KONSULTIME PËR VIKTIME DHUNËS

Njësitë e mjekësisë kundër dhunës

Lausanne

CHUV Pritja në Urgjente

📍 Rue du Bugnon 44
1011 Lausanne

📞 021 314 00 60

🌐 chuv.ch > UMV

UMV-Nyon

📍 Kati 3, 200 m larg stacionit
Avenue Reverdil 8
1260 Nyon

📞 021 314 08 51



NUMRAT E URGJENCËS

Policia

📞 117

Urgjenca mjeksore

📞 144

UMV-Rennaz

Qendra spitalore e Rennaz

HRC Vaud-Valais,

Pritja në godinën kryesore

📍 Route du Vieux-Séquoia 20
1847 Rennaz

📞 058 773 64 77

UMV-Yverdon-les-Bains

Spitali i Yverdon-les-Bains

Pritja në godinën kryesore

📍 Rue d'Entremonts 11
1400 Yverdon-les-Bains

📞 024 424 42 20

Fondation PROFA / Centres LAVI

🌐 profa.ch > Consultations > Centre LAVI

Lausanne

📍 Rue du Grand-Pont 2 bis
1003 Lausanne

📞 021 631 03 00

Aigle

📍 Rue du Molage 36
1860 Aigle
☎ 021 631 03 04

Yverdon-les-Bains

📍 Rue de la Plaine 2
1400 Yverdon-les-Bains
☎ 021 631 03 08

Violencequefaire.ch

Faqe interneti me informacione të përkthyer në dymbëdhjetë gjuhë, një shërbim përgjigjeje me email, për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë martesat e detyruara.

🌐 violencequefaire.ch

Centre d'accueil MalleyPrairie

Linjë telefonike 24/7 për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë martesat e detyruara, pavaresisht nga leja e qëndrimit ; akomodimin urgjent, konsultime ambulatorie.

📍 Chemin de la Prairie 34
1007 Lausanne
☎ 021 620 76 76
🌐 malleyprairie.ch
@ info@malleyprairie.ch

Centre Prévention de l'Ale

Për autorin/en/ët e dhunës që dëshirojnë ndihmë.

📍 Rue de l'Ale 30
1003 Lausanne
☎ 021 321 24 00
@ info@prevention-ale.ch
🌐 prevention-ale.ch

Bureau de l'égalité (BEFH)

Këshilla dhe orientim

☎ 021 316 61 24
@ info.befh@vd.ch
🌐 vd.ch/violence-domestique

Dhuna në familje dhe leja e qëndrimit

Viktimat e dhunës në familje mund të kenë frikë të humbin të drejtën e qëndrimit në Zvicër në qoftë se denoncojnë ose ndahen nga autori/ja i dhunës. Nëse keni nevojë për shoqërim dhe këshilla mbi situatën tuaj si emigrant, mund ti drejtoheni Centre Social Protestant CSP (Qëndres Shoqërore Protestante) edhe pse nuk keni leje qëndrimi të vlefshme.

CSP Vaud, La Fraternité, Qendra Shoqërore për emigranta

☎ 021 560 60 98
@ frat@csp-vaud.ch

JENI TË SHQETËSUAR NGA MARTESA E DETYRUAR

Konsulencë falas për personat në një situatë martesë të detyruar apo përballje me presionin e atyre që i rrethojnë për të filluar apo përfunduar një lidhje, këshilla për profesionistët që ndjekin këta persona.

BUREAU CANTONAL
POUR L'INTÉGRATION
DES ÉTRANGERS ET
LA PRÉVENTION DU
RACISME (BCI)



📍 Avenue de Sévelin 46
1014 Lausanne
☎ 021 316 49 59
@ info.integration@vd.ch
🌐 vd.ch/integration



7 SHKOLLA DHE FORMIMI

7.1 PËRPARA SHKOLLËS	74
7.2 NGA 4 NË 15 VJEÇ : SHKOLLË E DETYRUESHME DHE MIKPRITJA DITORE E TË RINJËVE	76
7.3 NGA 15 VJEÇ	80
7.4 TË GJENI NJË SHKOLLË PAS MBËRRITJES SUAJ	81



7.1 PËRPARA SHKOLLËS

KUJDESI PËR FËMIJËT

Nëse keni fëmijë të vegjël, mund të telefononi një qendër/çerdhe ose një person që të kujdeset në një mjedis familjar, i cili do të kujdeset për ta gjatë aktiviteteve tuaja (punë, kërkim pune, trajnim, kurs i gjuhës frënge). Çmimi i këtyre përfitimeve varion sipas pagës së prindërve.

Ju lutemi vini re se vendet janë të kufizuara dhe shpesh ka një listë pritjeje. Këshillohet që të kërkonit informacion gjatë shtatzënisë.

Ka edhe zgjidhje për kujdesin në shtëpi: kjo përfshin gjetjen e një nëne gjatë ditës ose një dado (të cilën do ta paguani vetë), parësish nga mosha e fëmijëve.

Kujdesi për fëmijët në kantonin Vaud është i organizuar në rrjete. Ju mund të kontaktoni komunën tuaj të banimit ose rrjetet e pritjes në listë.

MË SHUMË INFORMACIONE

- 🌐 faje-vd.ch/dispositifs/les-reseaux
- 🌐 vaudfamille.ch > VD > Garde d'enfants

LLOJET E NDRYSHME TË PRITJES

- 🌐 vd.ch Thèmes > Population > Enfance, jeunesse et famille > Accueil de jour des enfants ou Accueil familial de jour des enfants



➡ Kujdesi për fëmijët dhe kujdesi urgjent

Herë pas here, mund të telefononi edhe një dado që do të kujdeset për fëmijët tuaj për disa orë në mbrëmje ose gjatë fundjavës. Kryqi i Kuq trajnon të rinjtë për kujdesin ndaj fëmijëve dhe ofron shërbimet e tij mbështetëse familjare sipas të ardhurave neto të familjes, sipas tarifave të mëposhtme, si tregues: 4 franga në orë për të ardhura deri në 3500 franga dhe 6 franga në orë nëse është kujdesi për fëmijët gjatë mbrëmjeve të javës, fundjavave ose festave.

MË SHUMË INFORMACIONE

- 🌐 croixrougevaudoise.ch > Prestations > Baby-sitting

➡ Kryqin e Kuq Vaud

Në rast urgjence ose nëse fëmija juaj është i sëmurë ose ka pësuar një aksident, ju mund të telefononi shërbimet me pagesë të Kryqin e Kuq për t'u kujdesur për fëmijët tuaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

Service de garde d'enfants malades

📍 Rue Beau-Séjour 9-13

1002 Lausanne

📞 021 340 00 80

021 340 00 81

@ famille@croixrougevaudoise.ch

🌐 croixrougevaudoise.ch > Prestations > Garde d'enfants malades

📄 6.2 Roditeljstvo i rođenje deteta

AKTIVITETET PRIND-FËMIJË

Mësimet e frëngjishtes mbi shkollën u ofrohen prindërve.

Français en jeu

Kursi i frëngjishtes “Të mësosh në shkollë”

Poli Lausanne

📍 Place Pépinet 2
1003 Lausanne
☎ 021 329 04 49
@ lausanne@francaisenjeu.ch

Poli perëndimor vaudois

📍 Rue de l'Avenir 6
1020 Renens
☎ 021 552 44 04
@ ouest@francaisenjeu.ch

Poli lindor vaudois

📍 Rue des Remparts 7
Case postale 47
1814 La Tour-de-Peilz
☎ 021 552 44 05
@ riviera@francaisenjeu.ch

Poli Broyes et Gros-de-Vaud

📍 Rue Mauborget
1510 Moudon
☎ 021 552 44 03
@ moudon@francaisenjeu.ch

Fëmijëve u ofrohen atelie për t'u përgatitur për shkollën.

MË SHUMË INFORMACIONE

📖 10 Koha e lirë dhe jeta sociale

7.2 NGA 4 NË 15 VJEÇ : SHKOLLË E DETYRUESHME DHE MIKPRITJA DITORE E TË RINJVE

SHKURTIMISHT

Në Zvicër shkolla është e detyrueshme nga mosha 4 vjeçare dhe zgjat 11 vjet. Të gjithë fëmijët, pavarësisht nga statusi i tyre i qëndrimit, pranohen në shkollat publike, të cilat janë falas, në kantonin e Vaud. Për këtë arsye, studentët që nuk flasin frëngjisht do të përfitojnë kurse intensive, të cilat janë gjithashtu falas.

Kur të mbërrini, nëse keni fëmijë në moshë shkollore, duhet t'i regjistroni sa më shpejt të jetë e mundur në shkollën më të afërt me banesën tuaj.

KONSULTONI PLANIN VJETOR TË DREJTORIVE SHKOLLORE

 vd.ch > Autorités > Département de la formation, de la jeunesse et de la culture (DFJC) > Direction générale de l'enseignement obligatoire (DGEO) > Liste et contacts des établissements scolaires



Për regjistrime në qytetin e Lausanne-s, duhet të kontaktoni direkt me Shërbimin e shkollave dhe parashkollorit.

MË SHUMË INFORMACIONE

Direction de l'enfance,

de la jeunesse et des quartiers

 Place Chauderon | kati 5

Case postale 5032 | 1002 Lausanne

 021 315 64 11

 lausanne.ch/service-ecoles-parascolaire

Për tu informuar më shumë, konsultohuni me të gjithë dokumentet shpjeguese të sistemit shkollor të Vaud të përkthyer në 16 gjuhë.

DOKUMENTE INFORMATIVE TË PËRKTHYR PËR PRINDËRIT

 vd.ch > Thèmes > Formation > Scolarité obligatoire > Parent information and translated documents/Documents traduits d'information aux parents



Do të gjeni gjithashtu skema, sipas vendeve ku sistemi i Vaud-it krahasohet me sistemin e vendeve të ndryshme.

PËR TË GJITHA PYETJET QË LIDHEN ME SISTEMIN SHKOLLOR TË DETYRUAR

 vd.ch > Thèmes > Formation > Scolarité obligatoire

KURSE TË GJUHËS FRËNGE DHE KLASAT MIKPRITËSE

Në varësi të komunës së tyre të banimit, fëmijët që nuk flasin frëngjisht integrohen në klasa të rregullta me kurse intensive të frëngjishtes ose klasa pritjeje me kohë të plotë. Pas një ose dy vitesh, nxënësit në klasat e pritjes vazhdojnë shkollimin në klasën e rregullt të shkollës së detyruar ose të pa detyrueshme.

Studimi i detyrueshëm

MOSHA	KLASA	KURSI	
4 – 12	1P – 8P	Shkolla fillore	
		Orientimi	
12 – 13	9S	Shkolla e mesme Mësimi i përgjithshëm (2 nivele në frëngjisht, gjermanisht dhe matematikë)	Shkolla e mesme Pista para gjimnazit
13 – 14	10S		
14 – 15	11S		

15 – 16

Rakordime

Masat e tranzicionit

Post-detyruese

15 – 16	1.	Trajnimi profesional (të mësuarit)*	Shkolla e ekonomisë	Shkolla e kulturës së përgjithshme	Shkolla e maturës
16 – 17	2.				
17 – 18	3.				
18 – 19	4.	Matura profesionale post CFC**	Matura profesionale	Matura e specializuar	

Kalimi

I lartë

Shkolla e lartë e specializuar (HES)

Universiteti

*Studenti ka mundësi që gjatë praktikës të ndjekë kurset e integruara të maturës.

**CFC (Certifikata Federale e Kapacitetit) është titulli i lëshuar në fund të maturës

INFORMACION PËR STUDENTËT QË FLASIN NJË GJUHË TJETËR (ALLOPHONE)



vd.ch > Thèmes >

Formation > Scolarité obligatoire >

Les élèves qui parlent une
autre langue (allophones)

Zyra e mbështetjes pedagogjike dhe e mësimi të specializuar

Shërbimi siguron dhe mbështet arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve të moshës 0 deri në 20 vjeç me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta dhe mbështet procesin e integritimit social nëpërmjet formimit profesional.

Rue Cité-Devant 11

1014 Lausanne

021 316 54 01

info.sesaf@vd.ch

SHKOLLAT PRIVATE

Oferta e shkollave private u drejtohet prindërve që duan që fëmijët e tyre të vazhdojnë shkollimin sipas një kurrikule specifike, në një gjuhë të huaj, për të gjitha nivelet dhe moshat. Motori i kërkimit në faqen e internetit të Association vaudoise des écoles privées (AVDEP) do t'ju drejtojë në shkollat që korrespondojnë me nevojat tuaja.

MË SHUMË INFORMACIONE

avdep.ch

MIKPRITJA DITORE E FËMIJËVE

Sapo fëmija juaj të jetë në shkollë, strukturat mund të kujdesen për të, para, gjatë dhe pas shkollës. Ata në përgjithësi quhen APEMS (Pritja për fëmijët në ambient e shkollës) ose UAPE (Njësia e pritjes për nxënësit). Për më shumë informacion, mund të kontaktoni drejtpërdrejt rrjetin e kujdesit ditor të komunës suaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

10 Koha e lirë dhe jeta sociale

➔ Detyrat e mbikëqyrura ose të shoqëruara

Pas shkollës, studentët kanë mundësinë të marrin pjesë në detyrat e shtëpisë të mbikëqyrura ose të shoqëruara në prani të një të rrituri. Këto aktivitete ofrojnë një kornizë të favorshme për të mësuar. Një kontribut modest financiar mund të kërkohet nga prindërit. Për më shumë informacion, kontaktoni shkollën e fëmijës suaj.

MBËSHTETJE NDAJ PRINDËRVE

Shoqatat e prindërve të nxënësve (APE)

Ka rreth dyzet shoqata të prindërve në kanton. Ato mund t'ju ndihmojnë të kup-toni më mirë se si funksionon sistemi shkollor i Vaud-it, por edhe kujdesi ditor për fëmijët, detyrat e shtëpisë dhe transporti i mbikëqyrur. APE-në më afër jush do ta gjeni duke u konsultuar me faqen e internetit: ape-vaud.ch/ape-locales.

Avenue de Rumine 2

1005 Lausanne

021 341 90 77 | 078 689 63 63

info@ape-vaud.ch

ape-vaud.ch

MË SHUMË INFORMACIONE

histoires-de-parents.ch/soutien-orientation-parents

INFORMACION PËR TË MBËSHTETUR PRINDËRIT, FËMIJËT DHE TË RINJTË



🌐 vd.ch > Autorités > Départements >

Département de la formation de la jeunesse et de la culture DFJC > Direction générale de l'enfance et de la jeunesse DGEJ > Soutien aux enfants et aux jeunes

➔ Kurse për gjuhët dhe kulturën e originës (LCO)

Në mënyrë që fëmija juaj të zhvillojë gjuhën e tij amtare paralelisht me mësimin e frëngjishtes, kurset e gjuhës amtare dhe të kulturës (LCO) organizohen në kanton nga shoqata të ndryshme emigrantësh dhe ambasada të caktuara. Ju mund t'i regjistroni fëmijët tuaj në kurse italiane, portugeze, spanjolle, arabe etj., në varësi të ofertave ekzistuese. Shkollat ose bashkia do t'ju japin informacionin e nevojshëm për kurset e LCO që zhvillohen më afër shtëpisë tuaj.

MË SHUMË INFORMACIONE

📖 10 Koha e lirë dhe jeta sociale

7.3 PREJ 15 VJEÇ

PAS SHKOLLËS SË DETYRUAR

Në përfundim të kursit të tyre, studentët kanë mundësinë të vazhdojnë trajnimin e tyre duke zgjedhur rrugën që u përshtatet më shumë. Ata, ose mund të vazhdojnë studimet e tyre duke ndjekur trajnimin e gjimnazit i cili u jep akses në Shkollat e larta dhe në Universitet, ose të ndjekin trajnimin profesional duke bërë një praktikë.

➔ **Praktika me AFP dhe CFC**

Duke bashkuar teorinë me praktikën, shkollimi (ose trajnimi fillestar profesional) ju jep një certifikatë federale të aftësisë (CFC) në 3 ose 4 vjet ose një certifikatë federale të trajnimit profesional (AFP), në varësi të profesionit të zgjedhur, që ju çon në tregun e punës dhe/ose për trajnime të mëtejshme. Të nxënit vlerësohet shumë në Zvicër.

➔ **Qendrat rajonale të orientimit arsimor dhe profesional**

5 qendrat rajonale të orientimit arsimor dhe profesional do t'ju japin informacion mbi mundësitë ekzistuese.

Nëse e gjeni veten në një situatë të zgjedhjes së trajnimit, Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle (OCOSP) ofron shërbime të ndryshme duke ju ofruar një rrjet specialistësh të orientimit profesional si dhe shumë informacion për ju. OCOSP, me Qendrat e saj rajonale, mund t'ju ndihmojë të zhvilloni dhe realizoni projektet tuaja që marrin parasysh kërkesat e tregut të punës dhe trajnimit, aftësitë, prirjet dhe interesat tuaja, si dhe personalitetin tuaj.

Këto shërbime informacioni për studimet dhe profesionet dhe këto shërbime këshillimore, kolektive ose individuale, janë të destinuara për studentët dhe familjet e tyre, të rinjtë në tranzicion ose trajnim dhe të rriturit, gjatë gjithë jetës së tyre.

**GJENI SE CILËS
QENDËR SHKOLLORE
DHE PROFESIONALE
T'JU REFEROHENI**

 vd.ch > Thèmes >

Formation > Orientation > Contact
et adresses de l'OCOSP et
des centres d'orientation



7.4 TË GJENI NJË SHKOLLË PAS MBËRRITJES SUAJ

NGA 15 NË 25 VJEÇ

Jeni nga 15 deri në 25 vjeç, keni më pak se dy vjet që jeni në Zvicër, flisni pak ose aspak frëngjisht dhe po kërkonit trajnime? Portali i Emigracionit ju ofron një intervistë pranimit.

PORTAIL MIGRATION

📍 Rue de la Borde 3d
1018 Lausanne
📞 021 316 11 40
🌐 vd.ch > Thèmes >
Formation > Orientation > Pour
les personnes arrivées récem-
ment dans le canton de Vaud



BURSAT STUDIMORE

Shteti inkurajon financiarisht praktikën dhe vazhdimin e studimeve pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm, në varësi të kushteve të caktuara të kombësisë dhe vendbanimit. Kjo mbështetje synon të plotësojë ndihmën e familjes, nëse është e nevojshme për ta plotësuar atë. Kontakti Office cantonal des bourses d'études (OCBE) për të mësuar më shumë.

OFFICE CANTONAL DES BOURSES D'ÉTUDES (OCBE)

📍 Rue Cité-Devant 14
1014 Lausanne
📞 021 316 33 70
🌐 vd.ch > Thèmes > Formation >
Aides financières aux études et
à la formation professionnelle
bourses ou prêts

PËR TË MËSUAR NËSE KENI TË DREJTË PËR BURSË

📍 Rue Cité-Devant 14
1014 Lausanne
📞 021 316 33 70
🌐 vd.ch > Thèmes > Formation >
Aides financières aux études et à
la formation professionnelle (bourses
ou prêts > Questions fréquentes
sur les bourses/prêts d'études
et d'apprentissage > Quels sont les
critères pour demander une bourse/
un prêt d'études ou d'apprentissage?



Për të rinjtë nga mosha 16 vjeç dhe këdo në trajnim, Jet Service, Shërbimi social për të rinjtë i CSP Vaud ofron konsultime sociale dhe ligjore falas dhe konfidenciale në vende të ndryshme të kantonit, për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja në lidhje me arsimin, mirëmbajtjen, buxhetin për bursa, problemet financiare, borxhet, largimi nga shtëpia, vështirësitë familjare, ligji i punës, problemet me ligjin, aksesin në përfitime dhe çështje të tjera ligjore: sigurimet shoqërore, strehimi, kontratat etj.

Jet Service – CSP Vaud

@ jet.service@csp-vd.ch

🌐 csp.ch/jetservice

Lausanne

📍 Avenue de Rumine 2

1005 Lausanne

☎ 021 560 60 30

Yverdon-les-Bains

Maison des Associations

CSP Vaud – Pôle social

📍 Quai de la Thièle 3

1400 Yverdon-les-Bains

Payerne

CSP Vaud

Pôle social de la Broye

📍 Rue des Terreaux 10

1530 Payerne

Vevey

📍 Në ambientet e Ginkgo

Rue de l'Union 15b

1800 Vevey



8 GJENDJA CIVILE

8.1 TË RREGJISTROSH NJË TË SAPOLINDUR	84
8.2 NJOHJA E ATËSISË	85
8.3 MARTESA	86
8.4 PROCEDURA NË RAST VDEKJE	89

8.1 TË RREGJISTROSH NJË TË SAPOLINDUR

HAPAT QË DUHET TË NDIQNI

Lindja e një fëmije duhet të deklarohet në gjendjen civile të vendit të lindjes brenda 3 ditëve nga lindja. Në rast lindjeje në spital, ky i fundit kujdeset për lajmërimin e lindjes. Në rast lindjeje në shtëpi, babai, nëna, mamia, mjeku apo çdo person i pranishëm gjatë lindjes duhet ta lajmërojnë në gjendjen civile. Nëse prindërit nuk janë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, shërbimi kompetent do të kërkojë dokumente shtesë për të siguruar identitetin e prindërve. Pas këtyre formaliteteve, prindërit mund të kërkojnë certifikatën e lindjes në gjendjen civile.

Certifikata e lindjes mund të porositet me marrjen e njoftimit të lindjes, të transmetuar nga gjendja civile që ka regjistruar ngjarjen, e cila i nënshtrohet një tarife prej 30 frangash (plus shpenzimet postare).

Kur lindja ka ndodhur jashtë vendit dhe duhet të njoftohet në Zvicër, përfaqësia zvicerane e vendit të ngjarjes do t'ju ndihmojë me formalitetet.

Lindja e fëmijëve, prindërit e të cilëve nuk kanë nënshtetësi zvicerane, mund të shpallët edhe në ambasadën ose konsullatën e vendit të origjinës. Le Département fédéral des affaires étrangères (DFAE) harton një listë të përfaqësive të huaja në Zvicër dhe të përfaqësive zvicerane jashtë vendit.

Lindja krijon një marrëdhënie juridike midis fëmijës, nënës dhe burrit të saj.

Kur prindërit nuk janë të martuar, babai është i detyruar ta njohë fëmijën nëse dëshiron të njihet zyrtarisht dhe ligjërisht si babai i tij.

INFORMACION LIDHUR ME LINDJEN E FËMIJËS

 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes >
Population > État
civil > Naissance



KONSULTO LISTEN E PËRFAQËSIVE TË HUAJA NË ZVICËR

 eda.admin.ch > Conseils aux
voyageurs & représentations >
Représentations étrangères en Suisse

KUADRI LIGJOR

Njohja e atësisë është një akt juridik me të cilin një burrë pranon se është baba i një fëmije. Nëse prindërit e fëmijës nuk janë të martuar me njëri-tjetrin, filiacioni (marrëdhënia juridike) ndërmjet babait dhe fëmijës duhet të vendoset me akt juridik.

Njohja bëhet me deklaratë para nëpunësit të gjendjes civile. Në momentin që regjistrohet njohja e atësisë, lidhjet e filiacionit rregullojnë marrëdhëniet midis babait dhe fëmijës, d.m.th. detyrimi i ushqimit derisa fëmija të mbush moshën madhore, apo edhe deri në fund të jetës së fëmijës. të drejtat reciproke në çështjet e trashëgimisë dhe detyrat e ndërsjella në çështjet e ndihmës.

Që njohja e një fëmije të jetë e vlefshme, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- ➔ Vetëm babai biologjik mund ta njohë fëmijën. Personi i njohjes duhet të jetë i aftë për të dalluar.
- ➔ Nëse personi i njohjes është i mitur ose i ndaluar, është i nevojshëm pëlqimi i prindërve ose kujdestarit të tij.

Njohja mund të vendoset edhe nëse babai i fëmijës është i martuar me një grua tjetër. Njohja mund të bëhet para ose pas lindjes.

Kur nëna është e martuar në momentin e lindjes së fëmijës, ligji parashikon prezumimin e atësisë në favor të burrit. Në rast se ky i fundit nuk është babai i fëmijës, kjo lidhje filiacioni duhet të prishet përpara se të kryhet njohja. Për këtë qëllim, një procedurë refuzimi duhet të ngrihet para gjykatës kompetente.

Nëse babai refuzon ta njohë fëmijën, nëna ose fëmija duhet të ngrenë padinë për atësinë, në mënyrë që atësia të vërtetohet me proces gjyqësor.

Akti i njohjes është një deklaratë e parevokueshme. Njohja vendos lidhje midis babait natyror dhe fëmijës. Fëmija i njohur ka të drejtën e trashëgimisë nga babai i tij dhe të drejtën e ushqimit.

FILLIMI I PROCEDURËS SË NJOHJES SË ATËSISË

 vd.ch > Thèmes >
[Population](#) > État civil >
[Reconnaissance](#)



8.3 MARTESA

SHKURTIMISHT

E drejta për t'u martuar është e parashikuar në Kushtetutën Federale. Është zyra e gjendjes civile ajo që është përgjegjëse për zbatimin e tij. Edhe Zvicra njeh martesat e lidhura jashtë vendit.

KUSHTET

Që të bëhet një martesë, çifti i fejuar, qofshin zviceranë apo jo, duhet të plotësojë këto kushte:

- ➔ Të jetë të paktën 18 vjeç.
- ➔ Të jetë i aftë për të kuptuar. Të mos jetë i/e martuar.
- ➔ Të kenë lejen e përfaqësuesit ligjor nëse njëri nga dy personat është nën kujdestari.
- ➔ Të mos kenë lidhje vëllazërore (përfshirë gjysmë-motrat dhe gjysmë-vëllezërit), amësinë ose atësinë (përfshirë në rast birësimi) ose gjysh.
- ➔ Nëse njëri nga bashkëshortët e ardhshëm nuk është shtetas zviceran, ai ose ajo duhet të ofrojë dëshmi se është i autorizuar të qëndrojë në Zvicër deri në martesë.

Sidoqoftë, nuk mund të martoheni nëse:

- ➔ Ju jeni tashmë të martuar ose të bashkëjetoni në një partneritet të regjistruar.
- ➔ Ju nuk jeni të aftë për të kuptuar.
- ➔ Të mos kenë lidhje të ngushtë fisnore me personin.
- ➔ Martesa lidhet për t'u shmangur dispozitave për pranimin e të huajve.
- ➔ Martesa nuk është e miratuar dhe ju martoheni me detyrim.

PROCEDURAT MARTESORE

Për të qenë në gjendje të martoheni, duhet të paraqisni një kërkesë martese në zyrën e gjendjes civile.

CENTRE ADMINISTRATIF DE L'ÉTAT CIVIL

☎ 021 557 07 07

🌐 vd.ch > Thèmes >

Population >

État civil > Mariage



Më pas do t'ju duhet të plotësoni formularin “Hapja e procedurës përgatitore për martesë”, e cila dorëzohet nga zyra e gjendjes civile me kërkesë të çiftit. Në varësi të situatës, do t'ju duhet të paraqisni dokumente të ndryshme (i kushtoni vëmendje informacionit nga zyra e gjendjes civile). Pas dorëzimit të dokumenteve konfirmoni personalisht

pranë zyrës së gjendjes civile se i plotësoni të gjitha kushtet. Në rast kundërshtimi të pëlqimit tuaj, ekzistojnë shërbime asistence. Të detyrosh dikë të martohet është vepër penale dhe martesë mund të anulohet.

MË SHUMË INFORMACIONE

 6.3 Dhuna në familje

Jeni i/e prekur nga martesë e detyruar

Konsulencë falas për personat në një situatë martesë të detyruar apo përballje me presionin e atyre që i rrethojnë për të filluar apo përfunduar një lidhje, këshilla për profesionistët që ndjekin këta persona.

**BUREAU CANTONAL
POUR L'INTÉGRATION
DES ÉTRANGERS ET
LA PRÉVENTION DU
RACISME (BCI)**

 Avenue de Sévelin 46

1014 Lausanne

 021 316 49 59

 info.integration@vd.ch

 vd.ch/integration



Gjatë ceremonisë dy të fejuarit dhe dy dëshmitarët firmosin konfirmimin e martesës, të përgatitur paraprakisht. Në përfundim të martesës, bashkëshortët marrin certifikatën familjare.

Pagesat për martesën civile në përgjithësi variojnë nga 300 deri në 500 franga në Zvicër. Dëshirat e veçanta, të tilla si një festë të shtunën ose jashtë sallës zyrtare të dasmave të Lausanne-s, kanë kosto shtesë. Tarifat mund të kenë gjithashtu një kosto më të lartë, veçanërisht nëse keni dokumenteve të zyrave të gjendjes civile të huaja për t'u vërtetuar. Mund të martoheni edhe sipas riteve fetare, por vetëm pas ceremonisë civile.

Gjendja civile më pas shqyrton kërkesën tuaj dhe ju informon me shkrim nëse mund të martoheni. Martesë duhet të bëhet brenda 3 muajve nga përfundimi i procedurës përgatitore. Ceremonitë zhvillohen në sallat e martesës të kantonit ose drejtpërdrejt në ambientet e zyrës së gjendjes civile nëse zhvillohen menjëherë pas mbylljes së procedurës përgatitore të martesës. Ato mund të mbahen gjithashtu në “vende të jashtëzakonshme”, të listuara siç duhet (shih faqen e internetit të gjendjes civile). Duhet të jenë të pranishëm dy dëshmitarë kryesorë të aftë vepruar. Nëse çifti i fejuar nuk e kupton gjuhën e zyrës së gjendjes civile ku bëhet martesë, ata duhet të përdorin një përkthyes dhe të mbulojnë shpenzimet.

PROCEDURAT E NEVOJSHME PAS LIDHJES SË MARTESËS

Ndryshimin e statusit tuaj martesor duhet t'ua njoftoni autoriteteve, punëdhënësit, organeve tatimore, bankës, kompanive të sigurimit etj. Gjatë lidhjes së kontratave të reja duhet të tregohet edhe statusi i ri martesor.

Ju gjithashtu duhet të përshtatni dokumentet zyrtare kur mbiemri juaj ndryshon me martesën. Në veçanti, duhet të rinovoni dokumentet e mëposhtme:

- ➔ Pasaportë dhe kartë identiteti.
- ➔ Certifikata AVS.
- ➔ Leje drejtimi dhe leje qarkullimi.
- ➔ Kartat bankare dhe kartat e kreditit.
- ➔ Dokumentet e mëparshme.

RUAJTJA OSE NDRYSHIMI I MBIEMRIT PAS MARTESËS

Secili nga bashkëshortët ruan mbiemrin dhe vendin e origjinës. Megjithatë, të fejuarit mund të deklarojnë se duan të përdorin mbiemrin beqar të burrit ose gruas si mbiemër të përbashkët. Fëmija i prindërve të martuar merr ose mbiemrin e përbashkët ose, nëse prindërit kanë mbiemër të ndryshëm, mbiemrin e vetëm që prindërit kanë zgjedhur si mbiemër në kohën e lindjes nëse nuk janë martuar në Zvicër dhe nuk u është dashur ta bënin këtë zgjedhje në dasëm. Kur autoriteti prindëror ushtrohet ekskluzivisht nga njëri prej prindërve, fëmija merr mbiemrin beqar të këtij të fundit. Megjithatë, vini re se nëse prindërit janë të martuar, autoriteti prindëror ushtrohet bashkërisht.

Përveç kësaj, nëse nuk është fëmija i parë, fëmijët e mëposhtëm do të mbajnë detyrimisht mbiemrin e zgjedhur për fëmijën e parë, sipas parimit të unitetit të vëllezërve.

Duhet theksuar se, në dokumentet e zakonshme si letrat e identitetit, është e mundur të përdoret mbiemri i përbashkët, me vizë duke bashkuar mbiemrin e beqarisë me mbiemrin e bashkëshortit ose partnerit.

Për më tepër, në rast të zgjidhjes së martesës, në përfundim të procedurës së shkurorëzimit ose pas vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, bashkëshorti që ka ndryshuar mbiemrin në momentin e martesës, mund t'i deklarojë në çdo kohë nëpunësit se dëshiron të marrë mbiemrin e tij si beqar.

TË ZGJEDHËSH MIDIS MBIEMRIT TË NJËRIT APO TË TJETRIT

🌐 [vd.ch](https://www.vd.ch) > Thèmes >
Population > État civil >
Mariage > Choix du nom de famille
et lieu d'origine (droit de cité)



8.4 PROCEDURA NË RAST VDEKJEJE

SHKURTIMISHT

Çdo vdekje duhet të njoftohet brenda 2 ditëve në organet e gjendjes civile të vendit të ngjarjes. Kur personi i vdekur është i nënshtetësisë së huaj, u takon të afërmeve të tij që të njoftojnë vdekjen tek autoritetet e vendit të tyre të origjinës. Në rast të vdekjes që ndodh jashtë vendit, vdekja duhet t'i njoftohet autoriteteve zvicerane të gjendjes civile nëpërmjet përfaqësimit zviceran në vendit të vdekjes.

Në rast të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, bashkëshorti/ja që ka ndryshuar mbiemrin në përfundim të martesës mund të deklarojë në çdo kohë pranë nëpunësit të gjendjes civile se dëshiron të kthehet në mbiemrin e tij si beqar.

Varësisht se ku ka banuar personi i vdekur, është gjithashtu e nevojshme të njoftohen autoritetet komunale. Sidomos pasi shumë komuna zvicerane ofrojnë shërbime falas për funeralet (varrime, djegie, kortezh funerali, etj.); prandaj mund të jetë e arsyeshme të pyesni paraprakisht në mënyrë që të mund të përfitoni nga këto shërbime pa pagesë.

Gjithashtu vini re se është e mundur të bëni një kërkesë në bankën e personit të vdekur për të liruar fonde për të paguar shpenzimet që lidhen me funeralin. Shumica e institucioneve bllokojnë llogaritë në momentin e vdekjes (për shlyerjen e tatimit mbi trashëgiminë), por disa banka mund të ndërhyjnë.

**NJOFTIMI DHE
REGJISTRIMI I NJË
VDEKJEJE**

 vd.ch > Thèmes > Population > État civil > Décès



FUNERALI

Një person i vdekur duhet të transportohet në një vend të ruajtjes. Në përgjithësi, pas “konfirmimit të vdekjes” të lëshuar nga regjistri i gjendjes civile, autoriteti komunal autorizon transportin dhe varrimin e të ndjerit. Transporti bëhet nga një agjensi funerali e autorizuar nga Département de la santé et de l’action sociale (DSAS). Transporti gjithashtu mund t’i paraprijë njoftimit tek autoritetet. Në Zvicër, funeralet duhet të bëhen ndërmjet 48 dhe 98 orëve pas vdekjes. Në varësi të rajonit, funeralet mund të organizohen deri në 5 ditë pas vdekjes, kur trupi ruhet në një dhomë frigoriferike.

Zvicra pret një shumëllojshmëri të gjerë ritesh funerali. Prandaj, organizimi i funeralit do të varet shumë nga lloji i ceremonisë së zgjedhur, por cilado qoftë forma e tij, ceremonia e zgjedhur do të kërkojë një logjistikë bazë:

- ➡ Transferimi i trupit.
- ➡ Zgjedhja e vendit, datës dhe kohës së ceremonisë.
- ➡ Lista e njerëzve për të ftuar.
- ➡ Njoftimi i funeralit (për shembull me një njoftim mortor).

Është e zakonshme të thirret një përfaqësues funerali që t’ju shoqëroj në këto hapa.

Në fakt, qofshin privatë apo publikë (zyrtarë), agjensitë e funeralit mund t’ju mbështesin shumë herët në këtë proces dhe t’ju ndihmojnë me procedurat administrative si dhe me organizimin e funeralit. Ata kanë një rol bashkërendues ndërmjet familjes së të ndjerit dhe subjekteve të



KONTAKTONI DHE POROSISNI AKTET E GJENDJES CIVILE

Për porositë e dokumenteve të gjendjes civile (certifikatat e lindjes, certifikatat e vdekjes, etj.), ju mund t'i porositni në faqen e internetit të kantonit ose mundësisht të telefononi qendrën administrative. Më pas ato do t'ju dërgohen me postë.

CENTRE
ADMINISTRATIF
DE L'ÉTAT CIVIL

📞 021 557 07 07

🌐 vd.ch/etat-civil

🌐 [vd.ch > Thèmes >](#)

[Population > État civil >](#)

[Commander un acte d'état civil](#)



🔗 KËSHILLË

Mos harroni të njoftoni mbi këto ndryshime dhe konsullatën ose ambasadën e vendit tuaj të origjinës.

ndryshme ndërhyrëse dhe mund të ofrojnë edhe shërbime, si larja në mort dhe kujdesi i trupit. Punonjësit e kompanive funerale që kryejnë kujdesin mortor sigurojnë që ai të kryhet me respekt për dinjitetin e personit të vdekur dhe në përputhje me traditat e tyre kulturore dhe fetare. Agjensitë e funeralit zakonisht janë të gatshme të organizojnë homazhe që janë kuptimplotë për ju. Në të vërtetë, pavarësisht nga nevojat apo dëshirat tuaja në lidhje me funeralet dhe çfarëdo besimi, ju do të jeni në gjendje të gjeni një agjensi funerali, shërbimet e të cilit do të përshtaten në mënyrë të përkryer me pritjet tuaja dhe që do të jetë në gjendje t'i përmbushë ato me vëmendje dhe kujdes të madh, pa asnjë gjykim.

Listën e kompanive të ndryshme funerale si dhe më shumë informacion mbi këtë temë do ta gjeni në faqen e Drejtorisë së përgjithshme të shëndet.


DIRECTION GÉNÉRALE
DE LA SANTÉ
OFFICE DU MÉDECIN
CANTONAL

📍 Avenue des Casernes 2
1014 Lausanne

📞 021 316 18 00

🌐 [vd.ch > Thème > Santé, soins et handicap > Pour les professionnels > Autorisations de diriger et d'exploiter > Inhumations et pompes funèbres](#)





9 JETA E PËRDITSHME

9.1 TË UDHËTOSH NË RAJONIN E VAUD-IT	92
9.2 FINANCAT	94
9.3 TELEKOMUNIKACIONI DHE BLERJET	96

9.1 TË UDHËTOSH NË RAJONIN E VAUD

ME AUTOBUS DHE METRO

Mobilis është bileta e vetme e vlefshme për të gjithë kantonin dhe 309 komunat e tij. Ju lejon të përdorni të gjitha mjetet e transportit publik duke i kombinuar sipas dëshirës.

MË SHUMË INFORMACIONE

 mobilis-vaud.ch

Për udhëtime me një destinacion, biletat e autobusit mund të blihen direkt në stacionet e autobuzave ose me anë të telefonave smartphone. Në disa komuna, biletat mund të blihen nga shoferi i autobusit ose shoferja e autobusit.

ME TREN

Rrjeti i transportit publik zviceran është i gjerë dhe shumë i zhvilluar. Hekurudhat federale (CFF) ofrojnë bileta sezoni të tilla si bileta e përgjithshme e sezonit (AG) e cila lejon udhëtimin në të gjithë Zvicrën me transport publik (trena, autobusë, varka, metro, etj.) ose biletën e abonimit gjysmë-biletë që ju lejon të udhëtoni me gjysëm çmimi. Për më shumë informacion, kontaktoni sportelin në stacionin më të afërt ose konsultohuni me faqen e internetit të CFF.

MË SHUMË INFORMACIONE

 cff.ch

➔ Mobilis – Vaud

Ekuivalenti i AG për kantonin Vaud ekziston, është abonimi Mobilis i cili ju lejon të udhëtoni në të gjithë territorin e Vaud-it ose në një rrugë specifike (për shembull Lausanne – Yverdon-les-Bains) me transport publik.

MË SHUMË INFORMACIONE

 mobilis-vaud.ch

Është e rëndësishme të merrni informacion të plotë nga stafi i sportelit në stacione, në mënyrë që të zgjidhni abonimin më fitimprurës dhe që korrespondon më së miri me udhëtimet që do të bëni në bazë ditore.

➔ Bileta ditore

Disa komuna u ofrojnë banorëve të tyre, me çmime të favorshme, bileta ditore: ato mund të rezervohen me telefon, në sportel ose online në faqen e internetit të komunës suaj.

➔ Bileta me ulje

CFF gjithashtu ofron, në varësi të orarit, bileta me ulje (= çmim të reduktuar). Për të marrë këtë informacion, shkoni në faqen e internetit të CFF ose shkarkoni aplikacionin për smartphone CFF.

➔ Udhëtimi me fëmijë

Fëmijët nën 6 vjeç udhëtojnë falas nëse shoqërohen nga një person që mban një biletë të vlefshme dhe të ketë moshën 12 vjeç e lart. Me kartën Junior, për 30 franga në vit, fëmijët nga 6 vjeç deri në ditëlindjen



KUJDES

Për të qarkulluar në autostradat zvicerane, është e detyrueshme të blini kartën vjetore (40 franga) të cilën do ta ngjitni në xhamin e përparmë të automjetit tuaj. Mund të gjendet në stacionet e shërbimit, kioska ose në zyrën postare. Pulla vjetore është e vlefshme deri më 31 janar. Në atë datë, do t'ju duhet të keni marrë dhe ngjitur pullën e re në xhamin tuaj të përparmë.

e tyre të 16-të të shoqëruar nga njëri prej prindërve që mban një biletë të vlefshme transporti, mund të përdorin transportin publik falas për një vit të plotë. Karta Junior jepet falas nisur nga fëmija i tretë.

ME MAKINË

Personat që kanë patentë drejtimi jashtë vendit kanë të drejtë 12 muaj nga ardhja e tyre për të ndryshuar patentën e huaj me një dokument zviceran. Në varësi të vendit të origjinës, mund të kërkohet një provim praktik dhe/ose me shkrim.

SERVICE DES AUTOMOBILES ET DE LA NAVIGATION

📍 Avenue du Grey 110

1014 Lausanne

📞 021 316 82 10

@ isan.navigation@vd.ch

🌐 vd.ch/san

ME BICIKLETE

